E mërkurë, 1 qershor 2022

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.32

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes.

Znj. Sekretare, ju lutem a mund të thërrisni çështjen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

Atëherë, t'ju kërkojmë palëve të prezantohen.

Z. Prokuror, e keni ju fjalën.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Prokuroria sot përfaqësohet nga Silvia D'Ascoli, Prokurore e Asociuar; Julie Mann, Menaxhere e Çështjes; dhe unë Cezary Michalczuk, Prokuror në ZPS.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Avokate e Viktimave, ju lutem prezantohuni.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Jam ulur paksa më pas sot. Sot viktimat pjesëmarrëse përfaqëson nga Bechtje Vossenberg, bashkëavokate dhe unë Annie Pues që jam avokatja e viktimave.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Avokat i Mbrojtjes, fjala për juve.

Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar Gjykatëse. Mbrojtja përfaqësohet nga unë Julius Von Bone dhe z. Mustafa na ndjek me videolidhje. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Z. Mustafa, a na dëgjoni mirë? Punon videolidhja?

I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Me ju dëgju, po ju dëgjoj, po nuk ka video. Nuk ju shoh. Sallën e gjyqit nuk jam duke e parë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet të zgjidhet kjo z. Mustafa sepse duhet të jeni në gjendje që edhe të na shikoni. Do kërkoj që të zgjidhet kjo çështje përpara se sa të vijojmë më tej.

z. Mustafa, të lutem.

I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Tani po ju shoh. Tani ka fillu me ardh pamje të video prej sallës së Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Atëherë mund të vazhdojmë. Për procesverbal jeni përpara Trupit Gjykues I.

Në pajtim me vendimin e Trupit Gjykues mbi kërkesën e Prokurorisë për të paraqitur prova në pyetje plotësuese që është parashtrimi i protokolluar F424, sot do të dëgjojmë dëshmitarin e autorizuar nga Trupi Gjykues. Për shkak të masave mbrojtëse të cilat janë vendosur për këtë dëshmitar dhe faktin që ai në fakt ka dhënë një dëshmi përpara Trupit

Gjykues neve nuk do të përmendim pseudonimin e tij por do t'i drejtohemi atij vetëm si "z. Dëshmitar".

Përpara se sa të fillojmë me dëshminë e ditës së sotme, Trupi Gjykues dëshiron të japë një urdhër gojarisht për ZPS-në.

Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka përkthyer disa faqe të librit që janë shkruar nga dëshmitari i Mbrojtjes 1600. Faqet janë DSM00236 deri në 00299.

Këto fragmente janë nxjerrë nga ZPS-ja më datën 10 maj 2022 në orën 09.18 në paketën e nxjerrjes numër 139. Trupi Gjykues vëren se dokumenti DSM00257-DSM00266, përkthimi në anglisht është një përkthim i faqeve 266 deri në 275 të librit. Megjithatë, ne kemi vëmë re që faqja e parë e këtij dokumenti që është DSM00257 thotë datën 18 prill 1999 dhe ky është një element i cili nuk shfaqet në versionin origjinal të librit. Për rrjedhojë Trupi Gjykuesi i kërkon ZPS-së që të ridërgojë edhe një herë një version të korrigjuar të dokumentit DSM00257-DSM00266, përkthimin në anglisht deri të martën, data është 7 qershor 2022.

Ky është fundi i urdhrit të dhënë gojarisht.

Tani do të vazhdojmë me atë çfarë kemi në rendin e ditës për sot. Ju lutem a mund ta shoqërojmë dëshmitarin në sallën e gjyqit.

Znj. Sekretare, ndjesë. Shoh që ZPS-ja është në këmbë.

Z. Prokuror e keni ju fjalën.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund t'ju kërkoj që të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

Znj. Sekretare mund të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ju kërkojmë përzemërsisht që juve të vazhdoni me këtë dëshmitar tërësisht në seancë private. Kjo për tre arsye kryesore.

Së pari, në pajtim me urdhrin tuaj, të nderuar Gjykatës, ky është një dëshmitar i mbrojtur dhe mendoj që ai vetë do të shprehë dëshirën që ai të merret në pyetje gjatë të gjithë kohës në seancë të mbyllur për shkak të brishtësisë personale që ka.

Arsyeja e dytë është që, sot ne do të bëjmë disa pyetje të cilat kanë të bëjnë *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Dhe arsyeja e tretë e cila lidhet edhe me çështjen me arsyen e parë është që disa minuta më përpara unë dhe znj. D'Ascoli bëmë një takim me dëshmitarin. Thjesht e përshëndetëm dëshmitarin dhe vijuam me fjalët e zakonshme. Megjithatë, në mënyrë spontane dëshmitari tha që këtë të hënë *[REDAKTUAR]* e ka kontaktuar dhe i ka thënë që -- të njëjtën ditë, domethënë të hënën, që ishte kontaktuar nga dikush i cili kishte dhënë

emrin e *[REDAKTUAR]* i cili kishte filluar me një diskutim të çuditshëm lidhur me dëshmitarin, që dëshmitari ishte jashtë shtetit dhe në qoftë se *[REDAKTUAR]* mund të merrte një punë, mund t'i sigurohej një punë në kompaninë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*. Pra, eventualisht *[REDAKTUAR]* u inatos shumë dhe pra ky ishte një shkëmbim i cili fillimisht nisi *[REDAKTUAR]* dhe pastaj neve përkthyem këtë bisedën që kishte ndodhur përmes *[REDAKTUAR]*, nëpërmjet një aplikacioni *[REDAKTUAR]*

Pra, me fjalë të tjera, *[REDAKTUAR]* tha që e dinte se ku ndodhej dëshmitari, pra kishte përmendur edhe vendndodhjen e tij dhe ai mund *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* dhe për këtë arsye kishte kërkuar që të punësohej në kompaninë e *[REDAKTUAR]*.

Domethënë, diskutimi në vetvete është i çuditshëm, por thjesht doja që ta ndaja këtë me juve. Këtë na tha dëshmitari në diskutimin e shkurtër që ne mbajtëm. Pra ky ishte një informacion spontan që na u dha nga dëshmitari.

Pra, dëshmitari pas kësaj bisede, bisedë e cila iu tregua dhe iu tha nga *[REDAKTUAR]*, ai u prek emocionalisht, nuk kishte fjetur gjithë natën dhe ai mendon që kjo bisedë është bërë në lidhur me dëshminë që ai do të japë përpara Trupit Gjykues sot. Si ZPS ne nuk do të bëjmë pyetje lidhur me këtë çështje, por thjesht këtë çështje do të donim që t'jua vinim juve në dijeni, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues, që mbase

ju mund të bëni pyetje lidhur me të. Megjithatë, do të doja të thoja edhe një herë që *[REDAKTUAR]* dhe e lëmë në vlerësimin tuaj, të nderuar Gjykatës. Dhe mendoj që ky është një tjetër argument për të arsyetuar mbajtjen e të gjithë dëshmisë së dëshmitarit në seancë private. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

Kjo do të përfshijë edhe udhëzimet që do t'i jepen dëshmitarit? Këtë po thoni? Apo mendoni se sipas jush mund të fillojmë me udhëzimet duke i bërë këto udhëzime, duke ja dhënë dëshmitarit këto udhëzime në seancë të hapur dhe pastaj në momentin kur të fillohet me pyetjet me dëshmitarin mund të kalojmë në seancë private.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Udhëzimet mund të jepen në seancë të hapur por pastaj besoj që është mirë që të kalojmë në seancë të mbyllur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse kjo do të ishte e njëjta gjë. Do të ishte e ngjashme me atë çfarë kemi bërë në të shkuarën me dëshmitarët e ZPS-së. Me disa prej dëshmitarëve të ZPS-së. Dhe sigurisht që kemi pasur çështje që kemi kaluar shpesh herë në seancë të mbyllur dhe në seancë të hapur, por pjesa më e madhe ka ndodhur në seancë të mbyllur.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Le të jemi konsistentë atëherë

dhe kjo është në rregull si zgjidhje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Do t’i jap fjalën të gjithëve sa i takon kësaj çështjeje.

Mbrojtja e Viktimave, nuk e di nëse keni ndonjë gjë për të thënë lidhur me këtë çështje.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, faleminderit. Së pari, më lejoni të them që jam plotësisht dakord me kërkesën e Prokurorisë dhe mendoj që është tërësisht me vend dhe mund të shtoj gjithashtu edhe konstatimet e mia lidhur me këtë çështje që ishin në të vërtetë që dëshmitari *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Mbase *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* dhe si rezultat një seancë me mbyllura duket zgjidhja e duhur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtja, ju lutem fjala për juve.

Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, unë nuk mendoj se duhet të kalojmë në seancë private në të gjithë marrjen në pyetje të dëshmitarit. Mendoj se në qoftë se ka ndonjë pyetje të veçantë që do t’i bëhet dëshmitarit e cila mund të zbulonte identitetin e tij apo mund të zbulonte informacion që ka lidhje me këtë, mendoj se në këtë rast mund të ishte e përshtatshme që të kalonim në seancë private.

Megjithatë, unë nuk shikoj asnjë lidhje ndërmjet asgjëje

lidhur me këtë pikë. Së pari me kërkesë të dëshmitarit unë nuk shikoj asnjë arsye se pse duhet të kalojmë në seancë private në të gjithë seancën e ditës së sotme. Ndërkohë që sa i takon çështjes së ngritur nga Prokuroria unë nuk mendoj se ka ndonjë arsye apo marrëdhënie specifike të asaj çfarë është ngritur në këtë çështje, përveç imagjinatës së dëshmitarit që ai dëshiron që ne të kalojmë në seancë private.

Kështu që unë nuk besoj që është e nevojshme që ne të kalojmë në seancë private për të gjithë kohëzgjatjen e dëshmisë së dëshmitarit. Në qoftë se ne kalojmë një herë në seancë private dhe një herë në seancë publike, mendoj që kjo është një zgjidhje e balancuar dhe këtë e kemi bërë edhe herë të tjera. Kjo është mënyra se si duhet të bëhen pyetjet. Lidhur me temat shqetësuese, temat që u ngritën, nuk besoj se ka ndonjë gjë veçanërisht shqetësuese që të mund të dëmtonte dëshminë apo që mund të kishte të bënte me nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit. Dhe mendoj që kjo është arsyeja që pse janë vendosur masat mbrojtëse.

Pra, në përmbledhje, unë nuk besoj se është e domosdoshme që ne të kalojmë tërësisht në seancë private sot. Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Avokati Mbrojtës.

Z. Prokuror a ka ndonjë gjë tjetër që doni të parashtroni në këtë pikë? Mund të bëjmë edhe një raund tjetër për të parë

në qoftë se keni ndonjë gjë tjetër për të thënë.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës. I qëndroj të njëjtës gjë që sapo ju thashë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e di nëse Avokatja e Viktimave ka ndonjë gjë për të thënë.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shkurtimisht rregulli 120(3)(e), interesi i drejtësisë përfshin gjithashtu edhe gjendjen psikologjike të viktimave si dhe mirëqenien e viktimave. Dhe kjo sigurisht e kombinuar edhe me çështje të sigurisë që parashikohen në paragrafin 3(b), mund të justifikonte një seancë tërësisht private sipas pikëpamjes time.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë, Avokatja e Viktimave.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, z. Prokuror, fjala për juve.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, duhet t'jua kisha thënë edhe më përpara. Siç e thashë dëshmitar pak minuta më përpara përmendi këtë person me emrin *[REDAKTUAR]*. Dua t'ju kujtoj ju, të nderuar Gjykatës, që *[REDAKTUAR]* ka përmendur një person me emrin *[REDAKTUAR]* si një ndër personat që ai e ka takuar *[REDAKTUAR]* kur pretendohet që ai është ndaluar dhe është maltrajtuar. Dhe ndoshta kjo është një prej arsyeve sepse emri *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Thjesht po them – po jua jap këtë informacion të nderuar Gjykatës, që mbase ju mund ta përdorni për të vijuar më tej me disa pyetje për dëshmitarin, lidhur me këtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

Avokat i Mbrojtjes, keni ndonjë gjë për të shtuar?

Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kam ndonjë gjë specifike për të shtuar. Unë nuk mendoj se gjendja psikologjike e dëshmitarit mund të përcaktohet nga ndonjëri prej nesh këtu. Ne nuk kemi informacion tjetër lidhur me të nga *[REDAKTUAR]*. Nuk mendoj se kemi ndonjë arse për ta bërë këtë gjë, kështu që i qëndroj të njëjtit pozicioni që jua bëra me dije pak më parë.

Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Do të bëjmë një pushim prej pesë minutash në mënyrë që të mund të diskutojmë diçka ndërmjet nesh.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra, për një diskutim ndërmjet Gjykatësve dhe do të kthehemi përsëri

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancë a mund të na kaloni sërish në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të bëjmë pesë minuta pushim për të diskutuar një çështje ndërmjet Gjykatësve. Nuk dua që ta bëjmë këtë gjë këtu në sallën e gjyqit. Kështu që do të bëjmë pesë minuta pushim dhe do të kthehemi sërish në sallë.

--- Pauza fillon në orën 09.48

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes përsëri. Pas këtij pushimi që doli jashtë parashikimit tani do të japim një vendim lidhur me kërkesën e paraqitur prej ZPS-së. Dhe ky është urdhër gojor në përputhje me nenin 23(1) i Ligjit dhe rregullën 80 të Rregullores.

Trupi Gjykues do të parashikojë mbrojtjen psikologjike të dëshmitarit. Masat për mbrojtje përfshijnë edhe mundësinë që Trupit Gjykues të urdhërojë procedura të mbyllura.

Për më tepër rregulla 180, rregulla 20(3) parashikon që seanca të parashikojë seanca të hapura të mbyllura në interes të drejtësisë.

Mbështetur në informacionin që iu dha Trupit Gjykues nga Zyra për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe pasi vlerësuam se është në interes të drejtësisë të garantojmë se dëshmitari ta japë dëshminë në mënyrë të lirë, lirisht, pra, Trupi Gjykues miraton, aprovon kërkesën e ZPS-së për ta marrë dëshmitarin

tërësisht në seancë private.

Me kaq mbyllet urdhri me gojë i Trupit Gjykues.

Atëherë, tani do të vazhdojmë në seancë private dhe i lutem znj. Sekretare të Gjykatës të na kalojë në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Për procesverbal kemi të njëjtën përbërje të palëve. Duhet ta themi këtë edhe për publikun në fakt.

Ju kërkoj ndjesë znj. Sekretare duhet të dalim edhe një herë në seancë publike për të thënë që jemi në të njëjtën përbërje e do kalojmë përsëri në seancë private.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Vërej që kemi të njëjtën përbërje sikurse në seancën para pushimit. Kjo shprehet për procesverbal.

Ju lutem znj. Sekretare e Gjykatës na kaloni përsëri në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi sërish në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Asistente, ju lutem a mund ta sillni dëshmitarin.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mirëmëngjesi. Mirë se erdhët në Dhomat e Specializuara.

Më dëgjon?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] u desh të prisnit nga ora 9.30. ju kërkojmë ndjesë për këtë. Si je një herë?

DËSHMITARI: Mirë, mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, do të fillojmë me dëshminë tuaj në seancën e sotme. Por para se ta bëjmë këtë. Dua t'ju jap, të bëj disa komente. Më e rëndësishme është që më duhet të them se për të mbrojtur mirëqenien tuaj edhe në interes të drejtësisë e gjithë seanca, pra e gjithë dëshmia juaj do të bëhet në seancë private. Nuk do të jetë – nuk ndërrojmë midis seancave publike dhe atyre private.

E kuptoni këtë?

DËSHMITARI: Po. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t'ju them disa -- do të përmend disa nga masat mbrojtëse që ju

janë miratuar për dëshminë tuaj.

Nuk do të përmendim kurrsesi emrin tuaj. Do t'ju drejtohemi si "Z. Dëshmitar".

Ju është ndryshuar zëri dhe fytyra, ç'ka do të thotë se i akuzuari nuk mund ta shohë fytyrën tuaj, mund ta dëgjojë zërin tuaj, në fakt, por të ndryshuar. Normalisht keni edhe masa të tjera mbrojtëse, por meqë tani jemi në seancë private nuk është nevoja t'i përmend tani sepse nuk kanë më rëndësi, nuk kanë vlerë në këtë moment.

Dhe krahas masave mbrojtëse me kërkesë të Zyrës për Mbrojtjes së Dëshmitarëve ju janë miratuar katër masa të posaçme në përputhje me rregullin 80(4) dhe (5) i Rregullores. Dhe ka pasur një komunikim na ZMVD-ja më 30 maj që nuk ka ndryshuar rrethanat qysh prej asaj date dhe masat që ju janë miratuar, që ju janë dhënë, pra, herën e parë që keni ardhur vlejnë edhe në këto momente. Dhe këto masa janë që: i akuzuari nuk mund t'ju shohë drejtpërdrejtë, pra jeni i mbrojtur nga i akuzuari; ju lejohet të keni pushime sa herë që t'i kërkoni, nëse janë të nevojshme; se ka një psikolog për ju dhe sa herë të keni nevojë mund ta kërkoni dhe nëse kërkoni mund të ketë edhe ndihmë këtu në sallën e Gjyqit nga një pjesëtar i stafit që mund të ulet pranë jush. Por të gjitha këto janë me kërkesën tuaj.

Jashtë sallës së gjyqit sikurse ju kanë informuar, është një punonjës dhe një psikolog që ju presin që janë ulur diku

aty jashtë, në rast se ju keni nevojë të flisni me ta.

I kuptoni të gjitha këto?

DËSHMITARI: Po, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, ju kanë thirrur të dëshmoni para Dhomave të Specializuara në çështjen Prokurori kundër z. Salih Mustafa për të ndihmuar Trupin Gjykues të marrë vendimin. Pasi të bëni deklaratë solemne për të thënë të vërtetën do ju drejtojmë pyetje përfaqësuesit e zyrës së Prokurorit të Specializuar që janë ulur ty; Mbrojtësja e Viktimave që përfaqëson viktimat pjesëmarrëse; si dhe Avokati Mbrojtës që është ulur në krahun tjetër. Në fund edhe Gjykatësit mund të kenë disa pyetje për ju.

Qartë? Ju po pohoni me kokë. E kuptuar të gjithë këtë.

DËSHMITARI: Po, po. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani dua t'ju jap disa këshilla praktike për dëshminë tuaj z. Dëshmitar. Mbase ju i mbani mend nga hera e fundit por më duhet t’i përsëris për të siguruar që jeni në dijeni.

Çdo gjë që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet. Pra është e rëndësishme të flisni afër mikrofonit, pra para jush. Të flisni qartë, mos flisni shumë shpjet, flisni avash.

Duhet të filloni të flisni vetëm pasi personi që ju ka bërë pyetje e ka mbaruar pyetjen. Sepse kjo i jep kohë përkthyesve të përkthejnë pyetjen. Pra këshilla ime është

numëro deri në pesë me mendje pasi ju ka bërë pyetjen personi dhe vetëm atëherë përgjigjuni. Sepse shmang mbivendosjen e përkthimit mbi atë që po thoni ju. E qartë?

Nëse keni një pyetje, doni një pushim apo çfarëdo tjetër që ju nevojitet, ju lutem ngrini dorën dhe unë do ju jap fjalën në mënyrë që të shprehni atë ç'ka keni nevojë.

A është e qartë kjo për ju?

DËSHMITARI: Po. E qartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Siç bëjmë me çdo dëshmitar, tani do ju kërkoj të lutem të lexoni deklaratën solemne në të cilën thoni të vërtetën dhe ju kujtoj se është vepër penale në juridiksionin e Dhomave të Specializuara të jepni dëshmi të rreme.

z. Asistente ndihmojeni dëshmitarin të lexojë deklaratën solemne.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W01679 [Thirrur sërish]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit z. Dëshmitar. Tani jeni nën betim për të thënë të vërtetën.

Tani mund të fillojmë me dëshminë tuaj z. Dëshmitar. E do

të fillojmë me pyetjet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Z. Prokuror, duke pasur, duke mbajtur parasysh objektin e kufizuar të kësaj dëshmie, Trupi Gjykues ju ka caktuar një orë për pyetjet tuaja, por mund t'ju jepet më shumë kohë shtesë nga Trupi Gjykues nëse gjykohet e nevojshme. Ju lutem na informoni nëse ka ndryshim në këtë parashikim. Fjala është për ju.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës, një orë besoj se mjafton.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më falni z. Prokuror. Ne do të vazhdojmë deri në orën 1.00 tani. Kjo është e rëndësishme që ta dimë të gjithë. Dhe pastaj do të bëjmë pushimin e drekët.

Pyetje nga z. Michalczuk:

Py. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar. Si je?
Pë. Mirëmëngjes, mirë.
Py. Unë jam përfaqësues i Prokurorisë që do t'ju drejtoj pyetjet sot. Presim që të kemi një seancë të shkurtër me pak pyetje të fokusuara, të përqendruara. Jeni gati të filloni?
Pë. Po, [e padëgjueshme].
Py. Z. Dëshmitar, a e ke ndjekur proceset gjyqësore?
Pë. Po, i kam ndjekur. Jo të gjitha, po i ka ndjekur. Në përgjithësi po.
Py. Si i keni përcjellë, si i keni ndjekur pra?
Pë. I kam ndjekur përmes YouTube *[REDAKTUAR]*

Nëpër YouTube [e pakuptueshme] televizionet që e shfaq, RTK-ja.
Py. A ju kujtohet ndonjë seancë e veçantë në këtë çështje që u mbajt më *[REDAKTUAR]* Ju kujtohet seanca *[REDAKTUAR]*
Pë. Me datë kështu saktë nuk e di, po diçka më kujtohet, për një dëshmitar që ka qenë.
Py. A mund të na thoni për cilin dëshmitar po flisni?
Pë. Po, flas për dëshmitarin e tretë nëse s'gaboj, ka qenë *[REDAKTUAR]*.
Py. A ju kujtohet atë ditë kur po përcillnit atë seancë, ça ore, sa ishte ora kur filluat ta shihnit seancën?
Pë. Ora ka qenë dikun muj me thanë 11 e diçka e kam edhe në telefon e kam kështu saktë, por saktë nuk e di, 11 e diçka ka qenë kur e kam leshu me dëgju me këqyr se kush është.
Py. A ju kujtohet nëse e ndoqët seancën me atë dëshmitarin *[REDAKTUAR]* qysh nga fillimi? Pra e ndoqët qysh kur filloi dëshminë, që nga fillimi i dëshmisë së tij?
Pë. Jo, nuk ka qenë, nëse s'gaboj, nuk ka qenë bash prej fillimi se pak ma vonë unë e kam leshu me e këqyrë. Ka mujt me qenë pak më vonë kur ja kam nis me kqyr atë, me e përcjellë atë debat. Këtë seancë.
Py. Z. Dëshmitar a jeni në dijeni të faktit se kur përcillni seancat gjyqësore në televizion apo në mediat, në rrjetet sociale ka një vonesë 45 minuta, pra transmetohet 45 minuta me vonesë në rrjetet sociale apo në televizion. A jeni në dijeni

të kësaj?

Pë. Po jam në dijeni që transmetohet 45 minuta ma vonë po unë e ndez ma vonë e kam leshu me e shiku.

Py. Pra, si e kuptoj unë, kur po shihnit seancën ju patë një person të cilit i referoheni si *[REDAKTUAR]*, kështu?

Pë. Po, Unë e pashë që është ai person *[REDAKTUAR]*, tamam për të cilin edhe kam nëpër deklarata të mija prej *[REDAKTUAR]* e shihni aty që e kam që domethënë dhe u ndiva shumë keq kur pashë atë këtu në këtë karrige me dëshmitarë me viktima. E nuk m'u duk, nuk m'u duk, mos me ndërhy ashtu, u mundova me ndërhy tek ju me tregu se ky person është ç'ka shkruhet aty për të. Kam mendu që nuk jeni në gjendje ju ose diçka edhe me jua tregu.

Py. Si – çfarë ju bëri të besonit ju se është i njëjti *[REDAKTUAR]* ky që ka qenë me ju në Zllash? Çfarë ju ka bërë të besoni që ka qenë i njëjti *[REDAKTUAR]* që ka qenë me ju në Zllash në prill 1999?

Pë. Po ka shumë arsye dhe nëse s'gaboj para tri viteve ka pasë edhe intervista se ky ka -- para tri viteve nëse s'gaboj e kam pa edhe në televizion edhe kështu *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* nëse s'gaboj *[REDAKTUAR]*. Edhe aty e kam pa edhe është një njeri që nuk mundesh me e harrue se *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* edhe është njeri që *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Py. Kur po e shihnit seancën jua, kjo seancë e dimë nga

procesverbali që u mbajt më *[REDAKTUAR]*, kur po shihnit seancën si e njohët, nga a njohët ju? Çfarë ishte kaq e veçantë, qoftë në paraqitje apo në sjellje apo diçka që tha, që ju, iu bëri të besonit që ishte i njëjti *[REDAKTUAR]* për të cilin keni folur në dëshminë tuaj që i referohet kohës në Zllash në prill 1999?

Pë. Po mundesh me -- përmes *[REDAKTUAR]* që a konë pothuajse *[REDAKTUAR]*, prej atyne njerëzve edhe në fytyrë edhe nuk ma merr mendja, jo veç unë, por asnjë viktimë që nuk e njeh atë ose që e harron atë. Domethënë ç'ka kena përjetu prej tina. Nuk ka ndryshim, nuk ka ndryshim ai njeri, që me thënë diçka me ndryshu shumë. Është i njëjti person. Ndoshta mundet me kanë më i shëndoshë, ma i zhvillum ose diçka, ama i njëjti person, e njëjta fytyrë, i njëjti trup, krejt është e njëjta.

Py. Ju thatë se ishte *[REDAKTUAR]*. Për kë e keni fjalën kur thoni *[REDAKTUAR]*

Pë. E kam fjalën personal për këtë *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. Por kur thua "të gjithë ata", "ata" për kë e ke fjalën kur thua "ata"?

Pë. Po ka pasë edhe persona të tjera, i kam cek edhe në deklaratë, si për shembull *[REDAKTUAR]*. Këta njerëzit që kanë qenë aty.

Py. Pra po flisni për personat që ishin të pranishëm në

Zllash në prill 1999 kur dhe kaluat të gjitha ato që keni dëshmuar në këtë Gjykatë?

Py. Po, qatë. Ashtu.

Py. Çfarë bëtë kur e kuptuat, pra kur po shihnit seancën, çfarë bëtë kur e kuptuar që ai ishte *[REDAKTUAR]*?

Pë. Po s'di u ndiva shumë keq, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, njëjtë. Ashtu më erdh. Edhe kontaktova përmes kontaktit që kam unë, kontaktova menjëherë, i thashë "A mujna me ndërhy me i tregu edhe Prokurorisë edhe Gjykatës me ja spejgu se ky njeri është, nuk është një dëshmitar sikur gjithë të tjerët, *[REDAKTUAR]*".

Komunikova me personin që kam komunikim. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* ashtu, se *[REDAKTUAR]*. Me ja spjegu pak a shumë edhe e *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Py. Dhe ky personi që kontaktuat, mos e përmendi emrin nëse e dini, ju lutem, *[REDAKTUAR]*? I cilës organizatë? Nga cila njësi ishte personi që kontaktuat ju?

Pë. Ishte *[REDAKTUAR]*.

Py. E dini emrin *[REDAKTUAR]*?

Pë. Jo, emrin *[REDAKTUAR]* nuk e di. Më vjen keq.

Py. Pra, ju i *[REDAKTUAR]*, apo jo?

Pë. Po, në *[REDAKTUAR]*.

Py. I *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*?

Pë. Ja çova *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Py. Pse zgjodhët *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Pë. Po, ai sa di *[REDAKTUAR]* edhe unë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Ka pak e di, pak a shumë sa me u marrë vesh.
Py. A ju kujtohet përmbajtja e mesazhit që i çuat në *[REDAKTUAR]* saktësisht çfarë i shkruat?
Pë. Po, përafërsisht saktë nuk më kujtohet. E kam në telefon hala. E i tregova se e kam një problem e kam një hall, a mundesh me ma përcjellë këtë mesazh *[REDAKTUAR]* me pa këtë njeri se kush është edhe a e ngjojnë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Deshta me ma përcjell këtë mesazh te ju personalisht te Prokuroria ose tek Gjykatat, pa marrë parasysh. Me përcjellë atë se -- edhe faktikisht ai kur e pashë *[REDAKTUAR]*. Sikur në '99-n *[REDAKTUAR]* I njëjti send. Kur e pashë këtu ul si dëshmitar.
Py. E kuptoj. Në atë mesazh për të cilin po flasim, si ju referove atij personi? Në mënyrë ju drejtove atij personi të cilin ti e kishe dalluar?
Pë. Po *[REDAKTUAR]* drejtova sikur me i thanë "A je mirë, e kam një kështu, një hall një problem. A mundesh me ma përcjell këtë mesazh *[REDAKTUAR]*". Por thashë ndoshta nuk më kupton *[REDAKTUAR]* ça po du me thanë e lypa përkthyesen me më thirrë menjëherë ose

me më shkru. Edhe masnej *[REDAKTUAR]* tha veç OK edhe më thirri përkthyesja. Tani vazhdova me përkthyese bisedova këtë shqetësim ça e pata dhe aty met.

Py. Në fakt, pyetja ishte kështu pak më ndryshe. Kur po çonit mesazhin, në këtë mesazh si ju -- si e përmende emrin e këtij personit që kishe dalluar? E përmende personin, a e përmende me emër, a e përmende me mbiemër, këtë dëshmitarin që e kishe parë? Si e përmende? Si e vure në dukje pra?

Pë. Po u mundova me *[REDAKTUAR]* sqaru atyne se i thashë që ky dëshmitar, ky është *[REDAKTUAR]* që e kam në *[REDAKTUAR]* edhe u mundova me *[REDAKTUAR]* sqaru kush është, po nuk e kam zgjat aq shumë me to por veç kam thanë "Mundësisht me ma përcjellë tek *[REDAKTUAR]*.

Py. Në atë mesazh në fakt e përmende atë nofkën *[REDAKTUAR]* ti, tek mesazhi, tek përmbajtja?

Pë. Po e kam përmend, sa më kujtohet e kam përmend.

Py. A ju kujtohet pak a shumë sa qe ora kur qe ora kur çove mesazhin *[REDAKTUAR]*?

Pë. A kanë dikun, nuk e di saktë por para 12.00, aty dikun a konë. Se nuk e disha as ku me u orientu, as kujna me ja shfaqë këtë farë sendi. Nuk e disha ka me u orientu, kujna me i thanë. Por s'pata rrugëdalje tjetër, e pata qatë komunikim edhe vazhdova te ai.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj dua t'i tregoj Dëshmitarit disa komunikime që ne kemi

ruajtur në fakt dy ditë pas seancës. Pra, përkatësisht me *[REDAKTUAR]* dhe dua t'i bëj disa pyetje lidhur me këto.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, vazhdoni z. Prokuror.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Sekretare, do ju lutesha të vendosni në ekran dokumentin me ERN 105373 deri në 505375 RED, faqja 3 edhe faqja 2 nëse mund t'i shfaqni të dyja faqet në ekran. Është për hir të Dëshmitarit, po edhe për personat që nuk *[REDAKTUAR]*. E shohim këtu, po.

Py. Z. Dëshmitar, në të majtë të ekranit, nëse e shihni ekranin që keni përpara mund të shihni disa pamje fotografike, pamje të ekranit, pra, të mesazhit që keni dërguar. Dhe janë disa pjesë me të zezë. Mos u shqetësoni kemi redaktuar përmbajtjen, disa pjesë të mesazhit *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Po pjesa tjetër e mesazhit duket këtu.

E dalloni këtë shkëmbim mesazhesh, e njihni pra, këtë shkëmbim mesazhesh që keni përpara?

Pë. Po.

Py. Ky mesazh te kutia madhe, a është ky mesazhi që i keni dërguar atij personit pak pasi dalluat *[REDAKTUAR]* në seancë?

Pë. Po, ky është. Saktë është ky. Edhe shihet qartë që i kam thënë për me fol gjuhën shqipe se nuk e disha sa më kupton ky mua. Se unë as vetë nuk e di gjuhën mirë, por sado kudo u mundova pak me ndërhy.

Py. Nëse shohim këto shkëmbimin e mesazheve që keni ju përpara në ekran, a e shihni edhe orën kur ke çuar mesazhin e parë?
Pë. Mesazhin e parë. Po. Po shihet.
Py. Sa është ora aty, kur keni çuar këtë mesazh?
Pë. 11.15 edhe 11.16 ka kanë mesazhi. Po nuk i kam mbajt mend këto saktë, por që mirë që qekan, se s'i kam mbajt mend saktë se edhe në atë *[REDAKTUAR]*. A din kur e pashë diqysh më erdh si, si një farë lloj *[REDAKTUAR]* një farë, më erdh. Për qatë hupa edhe nuk e disha as sa i kam shkru, aq qysh me i shkru, as qysh me kontaktu me ju me ju tregu se ky person është ç'ka flitet.
Py. Duke parë shkëmbimin e mesazheve që keni përpara në ekran, ky shkëmbim a pasqyron bisedën që keni pasur ju atë ditë me personin të cilit i shkruat *[REDAKTUAR]*?
Pë. Po, saktë është ky.
Py. Z. Dëshmitar, Prokuroria nuk ka më pyetje të tjera për ju. Faleminderit për shpjegimet.

DËSHMITARI: Faleminderit.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

Avokatja e Viktimave, ju lutem a mund të vazhdoni menjëherë me pyetjet që keni apo dëshironi që të bëjmë një

pushim në mënyrë që të përgatiteni?

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës, jam e përgatitur që të vazhdoj përnjëherë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. E keni fjalën ju, e nderuar Mbrojtëse e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

Py. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar. Unë jam Avokatja e Viktimave. Nuk jam ulur në vendin e zakonshëm, i kam lënë hapësirë psikologes për të ndihmuar në qoftë se do të jetë e nevojshme. Faleminderit për gjithë informacionin që na vutë në dispozicion sot paradite.

Pë. [e padëgjueshme].

Py. Unë shkurtimisht dëshiroj të bëj disa pyetje pasuese të cilat kanë të bëjnë me këtë ditë specifike, me këtë ditë konkrete pra me *[REDAKTUAR]* e këtij viti, në mëngjes, kur ndodhi incidenti që sapo na shpjeguat, na e përshkruat.

Një gjë që dëshiroj t'ju pyes është: A ju kujtohet nëse dëshmitari në atë pikë, e kishte përmendur pseudonimin e vet apo jo gjatë dëshmisë që ju kishit qenë duke dëgjuar në atë datë?

Pë. Jo, nuk e më kujtohet. Nuk ka përmend kurrgjë. Po si e kam vazhdu me këqyr automatikisht e kam njoh atë njeri se nuk e harroj. Është në memorien time, është në blicin tem, ai njeri nuk mundet me u hek prej blicit, kurrë në jetë. Edhe

është njeri që çdo dëshmitar, çdo viktimë i cili ka qenë qaty, nuk ma marr mendja që s'e njeh atë edhe nuk e din ç'ka ka bo ai. Po te unë, në memorien time personale te unë, ai njeri nuk e harroj kurrë, deri në frymën e fundit.

Py. Pasi -- ju kërkoj ndjesë.

Pasi i dërguat mesazhin personit të kontaktit a vazhduat më tej që të dëgjonit dëshminë e tij?

Pë. Po kam vazhdu edhe më tej, pak a shumë se jo, se isha shumë nervoz. Isha diqysh isha në siklet të madh. Nuk mujsha me marrë me mend me paramendu ato *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* është ai, një njeri, njeri, njeri *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* a din. Nuk e mujsha me marrë me mend që është ulur këtu në këtë karrige ku janë dëshmitarët. E din, me një çast edhe *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, ato sendet e tijna edhe e ndijsha këtu ça fol, nuk kisha as *[REDAKTUAR]*.

Py. A mundesh të kujtosh në qoftë se në një pikë të mëvonshme të dëshmisë së tij, në qoftë se siç e kuptoj, juve e keni parë pjesërisht sepse ishit *[REDAKTUAR]*, a ju kujtohet në qoftë se dëshmitari e përmendi pseudonimin e vet *[REDAKTUAR]*, apo jo?

Pë. Është e mujshme që -- s'po më kujtohet tash. Po është e mujshme që e ka përmend diku ma vonë, pjesë-pjesë kur kam këqyr. Më kujtohet kur Prokurorja, nëse s'gaboj, janë kanë disa çaste kur e ka përmend diçka që është i akuzum apo ku ta

di une. Nëse s'gaboj qaty ka qenë ajo. Është e mujshme.

Py. Faleminderit. Duke vazhduar më tej dhe lidhur me atë se si jeni ndjerë lidhur me ketë përvojë. Na e thatë edhe më përpara që u ndjetë shumë keq dhe *[REDAKTUAR]* dhe këtu i referohem faqeve nga 19, rreshti 12, për shembull dhe gjithashtu e përmendët këtë edhe në faqen 20, rreshti 10. A vazhduan këto ndjesi më pas? Si jeni ndjerë më pas pasi dëgjuat këtë dëshmi? Si jeni ndjerë atë ditë apo ditët më pas, madje edhe muajt më pas?

Pë. Po prej asaj kohe *[REDAKTUAR]*. *[REDAKTUAR]* kurrë se qysh sikur më ka ardhur sikur *[REDAKTUAR]*, sikur -- si, si *[REDAKTUAR]*, si lloj, a din. Nuk jam ndi mirë, prej asaj kohe, kurrë hiç. Edhe kam pasë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Py. Kur thoni që keni thënë shumë i stresuar, si është demonstruar, si është shfaqur stresi? Ose ndoshta t'jua bëj pak ndryshe pyetjen, t'ju pyes në më tepër përgjithësi.

*[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* [e pakuptueshme] nuk kisha ndërhy, por të ishte

kanë një dëshmitar tjetër as send, por tek ai nuk kam pasë qare. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Ata këta m'i
*[REDAKTUAR]* Këta m'i kanë bo. Këta më kanë *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Lloj-lloj simptoma. Lloj-lloj.
Py. Pra, a do ishte e saktë të thuhej se *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* si rezultat i asaj çfarë keni parë dhe çfarë keni dëgjuar atë mëngjes, apo jo?
Pë. *[REDAKTUAR]*.
Py. Faleminderit z. Dëshmitar. Këto ishin pyetjet e mia. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Mbrojtësja e Viktimave.

Avokati i Mbrojtjes, cili do të ishte momenti i përshtatshëm për juve? Mund të vijoni tani dhe pastaj të përdorni pushimin që të mund ta shikoni pak më afër çështje të tjera apo pyetje të tjera që do të doni t'i bëni dëshmitarit. Apo dëshironi që të bëjmë një pushim tani dhe pastaj të vazhdoni me pyetjet tuaja më pas.

Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që të bëjmë një pushim në këtë pikë në qoftë se do të jetë e mundur. Mendoj që është më efikase që unë të shikoj më nga afër dhe ndoshta të zhvilloj disa pyetje të tjera shtesë për temat që u cekën. Mendoj që do të ishte më gjithëpërfshirëse

në qoftë se do të kisha më shumë kohë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Kam një pyetje tjetër. Filluam pak më vonë sot. Nuk e di në qoftë se do ishte e mundur që ta shkurtoja pak pushimin. Është problem për juve apo jo?

Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk është problem për mua

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në qoftë se bëjmë një orë pushimin, është në rregull apo jo? Do të përpiqemi që të mos e mbajmë shumë të gjatë ditën sot. Sigurisht që kemi planifikuar ditën tjetër, por gjithsesi.

Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk ka problem, e nderuar Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë, z. Dëshmitar tani do të bëjmë një pushim deri në orën një pa një çerek. Në orën një e një çerek. Dhe pastaj do ju kërkojmë që të ktheheni sërish që të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Do ta ketë radhën avokati mbrojtës pasi të kthehemi pas drekës.

Është e qartë kjo për juve?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Sekretare do t'ju nxjerrë nga salla. Ju uroj pushim të mbarë për drekë.

DËSHMITARI: OK, faleminderit, gjithashtu.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare ju lutem a mund të kalojmë përsëri në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] faleminderit znj. Sekretare e seancës.

Tani kemi përfunduar me pyetjet e ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave. Do të bëjmë një pushim për një orë, deri në orën një e një çerek në kohën në të cilën do të vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtja.

Faleminderit, seanca ndërpritet këtu.

--- Pauza e drekës fillon në orën 12.12

--- Seanca rifillon në orën 13.16

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët.

Shoh që përbërja e ekipeve është e njëjtë si më parë. Z. Mustafa po ashtu po na ndjek. Kështu që mund të vazhdojmë.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

Sekretare, ju lutem a mund ta shoqëroni dëshmitarin brenda sallës.

[Dëshmitar vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët, z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi në seancë private tani sa për informacion.

Tani do t'ia jap fjalën Avokatit të Mbrojtjes, i cili do t'ju bëjë pyetje.

Z. Avokat, fjala për juve.

Dhe sa për informacionin tuaj, z. Avokat i Mbrojtjes, keni gjithashtu në dispozicion një orë. Dhe nëse keni nevojë për më tepër kohë, keni mundësinë që t'i drejtoheni Trupit Gjykues që t'ju japë më shumë kohë në dispozicion. Ju lutem më informoni në qoftë se mendoni se keni nevojë për më tepër sesa një orë.

Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone:

Py. Mirëdita, z. Dëshmitar.
Pë. Mirë se ju gjej. Mirëdita.
Py. Më dëgjoni mirë?
Pë. Po.
Py. Unë nuk ju dëgjoj mirë, kështu që ju lutem mund ta ngrini

pak zërin.

Z. Dëshmitar, sa herë e keni parë dëshminë e dëshmitarit, e kam fjalën për dëshmitarin që keni njohur juve, që keni dalluar ju, sa herë e keni parë gjithsej intervistën?

Pë. Këtë intervistë që po folim sot? Për këtë person që po bëhet fjalë?

Py. Do ta shpreh ndryshe. Ju na thatë që keni parë televizor, e keni përcjellë në televizor procesin dhe keni njohur këtë personin. Pyetja ime është kjo: Sa herë e keni parë atë personin që ka dhënë dëshminë në televizion apo në mjete të tjera komunikimi ose medie?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat, për mua nuk është e qartë pyetja, as unë nuk e kam të qartë pyetjen? Kështu që, ju lutem a mund ta shprehni ndryshe.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Ditën kur keni përcjellë në televizor procesin dhe keni njohur këtë person, a ka qenë hera e vetme që ju e keni parë dëshminë e atij personi apo e keni parë dhe herë të tjera dëshminë e këtij personi?

Pë. Unë dëshmi tina s'kam pa. E kam pa më përpara edhe në *[REDAKTUAR]* diçka. E kam dhe ma herët edhe kur ka qenë në seancë këtu.

Py. E kuptoj. Lidhur me këtë momentin që e *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* i diçkaje, sa kohë më përpara ka ndodhur kjo gjë?

Pë. Kohën nuk e di saktë. Mund me i pasë ndoshta nja tri vite, apo muj me thanë tri vite, katër vite.

Py. Më pas e patë atë që të jepte dëshmi në Gjykatë. Dhe pyetja ime është kjo: Kjo dëshmia që dha ky personi lidhur me të ju njoftuat një person? Pyetja ime është kjo: Po pas këtij momenti, a ke parë më ti atë dëshminë e këtij personi? A e ke përcjellë më dëshminë e atij personi pas këtij momenti?

Pë. Jo, mu s'më ka interesu më. S'më intereson mu hiç. Mu duk *[REDAKTUAR]* prej anës juj me atë dëshmitar edhe për atë punë ndërhyra. Se nuk më intereson me ndëgju ai çka thotë absolut. Se e di kush është edhe çka është edhe po mu duk si *[REDAKTUAR]* prej anës tuaj.

Py. Po. E kuptoj. Thjesht dua që të sigurohem që e kam kuptuar drejtë atë çfarë thatë juve që ju e keni përcjellë vetëm një herë këtë person, ndërsa ai jepte dëshmi; a është e saktë kjo?

Pë. Sa ka dhënë dëshmi herë pas here e kam përcjellë, e thashë edhe ma herët, e kam përcjellë herë pas here, po nuk më ka interesu çka thotë, as çka ka thanë. As më ka interesu as më intereson. As sot s'më intereson. Unë veç kam deshtën me tregu se kush është ai. Se e kam desh me tregu këty që nuk është për qët karrige ai. Po është ai pacienti tjetër aty. Ku aty e ka vendin.

Py. Ju thatë sot në dëshminë e dhënë se ju e keni përcjellë gjyqin kundër të akuzuarit në përgjithësi; a është e saktë

kjo?
Pë. Nuk muj me thanë në përgjithësi që e kam përcjellë. Se kisha kishte seanca të mbyllme, ki plane dhe kur s'më bën përshtypje mu një diçka unë s'e përcjelli. Dhe shembull, ça janë fjalë të personit, klientit juaj, mu s'më intereson me përcjellë çka thotë ai ose diçka. *[REDAKTUAR]*, e di çka është ai. Nuk është ajo që e kam përcjellë unë çdo seancë, çdo fjalë, çdo send, se në atë farë momenti *[REDAKTUAR]* edhe e *[REDAKTUAR]*.
Py. Jo. Por përpara këtij dëshmitarit konkret që dha dëshminë, a keni përcjellë dëshmitarë të tjerë të cilët kanë dhënë dëshmi përpara Gjykatës përpara ose pasi keni bërë përcjelljen e këtij personi në televizion? Dhe në televizion, e kam fjalën, kur ai po jepte dëshmi këtu përpara Gjykatës?
Pë. Po ka raste që kam përcjellë disa seanca të klientëve tuaj që i keni ftu, ka.
Py. Në rregull. A keni pasur dëshmitarë të tjerë që ju i keni njohtë?
Pë. Po, ka pasë. Për shembull, ka qenë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, që ka qenë këtu.
Py. Po ndonjë person tjetër?
Pë. Nuk muj me specifiku bash saktë, po edhe te *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* kam pasë disa dyshime.
Py. Dëshiroj t'i kthehem dëshmisë që është bërë nga personi që keni njohur ju.

Thatë më herët se keni njohur dhe këtu i referohem transkriptit në faqen 16, rreshti 14: "Po. Unë pashë që ishte *[REDAKTUAR]*, të cilit unë i jam referuar *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*".

Pë. Po, e saktë është.

Py. Po. Çfarë deklaratash keni dhënë ju, në fakt, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Pë. Kam dhanë qështu deklarata të njëjtat. Kam kallëzu për këta njerëz që janë ky grupi i kriminelave kështu që i kanë bë këto turtura, këto vrasje, këto sende. Këta e kam shpjegu edhe *[REDAKTUAR]* edhe tash. Për këto gjëra.

Py. Dhe për cilat deklarata specifike flisni *[REDAKTUAR]*?

Pë. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Py. A kanë qenë deklarata këto në *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*?

Pë. Po.

Py. Në rregull. Shumë faleminderit.

Z. Dëshmitar, kur keni përcjellë në televizor dhe keni parë personin që po jepte dëshminë keni qenë vetëm atëherë?

Pë. Jo, *[REDAKTUAR]*.

Py. Në rregull. A po e *[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, nuk e përcjellin *[REDAKTUAR]*, zakonisht vetë. Ku të muj e përcjellin *[REDAKTUAR]*, pa marrë parasysh.

Py. Mirë. Po a e diskutove *[REDAKTUAR]* momentin kur e

dallove këtë personin, a fole bashkë me ta?

Pë. Po ndoshta edhe kam diskutu.

Py. Po ju pyes, a diskutuat apo nuk diskutuat?

Pë. Po.

Py. Po për çfarë diskutuat konkretisht?

Pë. Diskutuam për X personin se ish *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, shumë thjesht. Edhe thashë se du me ndërhy këtu se *[REDAKTUAR]* kjo. Me thanë mu po mu duk *[REDAKTUAR]* ndaj meje, *[REDAKTUAR]*, me ta pru *[REDAKTUAR]*, *[REDAKTUAR]*, që sot *[REDAKTUAR]*, me ta pru me ta ulë këtu, është *[REDAKTUAR]*. Me thanë ai që e pashë *[REDAKTUAR]*

Py. Me kë *[REDAKTUAR]* e diskutove këtë gjë? Me cilin anëtar të familjes? Me kë konkretisht domethënë?

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. Në rregull.

Py. Po me ndonjë tjetër, përveç *[REDAKTUAR]* e diskutove?

Pë. Jo, s'e kam diskutu.

Py. The që u mërzite, u shqetësove, u stresove. Kështu?

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

ba.
Py. Sa herë je konsultuar me psikologen, sa herë ke shkuar tek psikologja?
Pë. Po nuk e di. Nuk e di saktë.
Py. Më shumë se një herë?
Pë. *[REDAKTUAR]*
Py. Po ju pyes unë ju, a ka qenë më shumë se një njëherë? A mund të na thuash ka qenë një herë apo më shumë?
Pë. Më shumë.
Py. Z. Dëshmitar, kur kontaktuat Dhomat e Specializuara të Kosovës, pra, kur ishit në kontakt me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe me Prokurorin, Prokurori përgatiti një raport lidhur me këtë edhe unë dua të lexoj dy fragmente, dua të diskutoj dy fragmente të këtij raporti për të cilin po flas dhe unë do t'i citoj në fakt.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë do të citoni z. Avokat? Po të cilit dokument?
Z. VON BONE: [Përkthim] Atë do ta them tani. Është Nota Zyrtare ERN 105371, që është në fakt materiali që lidhet me këtë aspekt që po diskutojmë.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mendova se do të citonit nga raportet.
Z. VON BONE: [Përkthim] Quhet Nota Zyrtare.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë dëgjova fjalën raport, po mund ta kem keqkuptuar unë.

Vazhdoni.

Z. VON BONE: [Përkthim] Është Nota Zyrtare e ZPS-së, ERN 105371. Nuk e di a është nevoja ta nxjerrim në ekran, por unë do të citoj paragrafët.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund ta vendosni në ekran dokumentin që përmendi z. Avokat, ju lutem.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Z. Dëshmitar, do të citoj paragrafin 3 dhe 4 për ju. Do ta them ngadalë dhe pastaj do ju bëj pyetje vijuese.

"Në momentin që kuptoj se kishte njohur, dalluar *[REDAKTUAR]*, W01679 menjëherë i çoj mesazh *[REDAKTUAR]* në *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*, në të cilin u kërkonte të informonin Prokurorët lidhur me faktin që kishte identifikuar këtë person. Mesazhin e çoi në orën 11.15".

Z. Dëshmitar, a është e saktë kjo që unë citova, lexove?

Pë. Po, e saktë po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prisni pak, ju lutem.

Z. Dëshmitar, a mund t'i hiqni pak dëgjueset, ju lutem?

Mbrojtësja e Viktimave, shoh që jeni në këmbë. Keni fjalën.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Po. Do të doja të vija në dukje, kjo është një pyetje që nuk mund t'i përgjigjet dëshmitari se

nuk e ka shkruar ai këtë notë, ai s'mund të dëshmojë lidhur me saktësinë a është e saktë kjo çka është shkruar këtu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase, avokate, është një pjesë e këtij mesazhit - po i drejtohem dhe Avokatit i Mbrojtjes – është një pjesë këtu për të cilën ai s'mund të dëshmojë. Përpara e pyetëm *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Ai tha se nuk e dinte, nuk e dinte emrin e njësisë. Kështu që --

Z. VON BONE: [Përkthim] Po nuk dua të dalë këtu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, po e kuptoj. Po ju doni që ai të thotë nëse është e saktë apo jo që është thënë këtu, por ai nuk mund ta thotë për të gjitha pikat këtu a janë të sakta apo jo. Prandaj ju lutem a mund ta hiqni atë -- ta ndryshoni pyetjen, të mos i referoheni këtij paragrafi konkret atëherë.

Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Kështu do të veproj, po nuk është shumë problem ky paragraf, por paragrafi tjetër. Unë thjesht dua të sigurohem. Mu duk më e logjikshme ta them në këtë formë, në përgjithësi. Po nuk ka problem. Nuk ka asnjë problematikë këtu. Unë thjeshtë dua të siguruar në të vërtetë a i ka kontaktuar apo jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky paragraf konkret -- ju mund ta kishit thënë: Ju keni dëshmuar sot paradite që në momentin që dalluat dëshmitarin si dikush që ju e njihnit me nofkën *[REDAKTUAR]*, ju kërkuat që të

informohej përmes *[REDAKTUAR]*, Prokuroria. Për këtë dëshmuat sot paradite. Dhe pastaj dilnit te pika tjetër pa i kërkuar atij specifikisht të pajtohet ose jo me paragrafin. Kjo është ajo që po përpiqem të them.

Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, atëherë po e lë këtë pikë dhe po kaloj tek pika tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Z. Prokuror, fjala është për ju.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Thjesht për procesverbal. Kjo Notë Verbale është përgatitur nga ne, ZPS-ja, pas bisedës që patëm me dëshmitarin, po kjo notë nuk ju dha atij për ta nënshkruar nëse është e saktë apo jo. Prandaj dhe vendosëm ta thërrasim fizikisht të dëshmojë. Kjo është një notë që pasqyron mënyrën sesi e kemi kuptuar ne atë që ka thënë ai. Për procesverbal doja që ta qartësoja këtë pikë. Nuk është deklaratë dëshmitari kjo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për këtë sqarim. Unë s'e kisha kuptuar më ndryshe sidoqoftë.

Avokat, a mund t'i kërkoj dëshmitarit të vendosi sërish dëgjueset dhe vazhdoni me pyetjet?

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Z. Dëshmitar, do ju lexoj paragrafin tjetër atëherë.

"Dëshmitari W01679 i konfirmoi Prokurorit dhe Prokurores

se personi që pa teksa po dëshmonte -- personi që pa që po dëshmonte më *[REDAKTUAR]*, në fakt, ishte *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* në Brigadën 153, *[REDAKTUAR]* dhe më pas e *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Pyetja ime është: Në fakt, në të vërtetë e konfirmuat ju këtë gjë? Pra, këtu është shkruar që e keni konfirmuar, po në të vërtetë e konfirmuat ju këtë gjë?

Pë. Po.

Py. Dhe më pas thuhet. Po ju lexoj paragrafin:

"Dëshmitari W01679 tha se ishte 'absolutisht pozitiv', i sigurt pra, që e kishte njohur *[REDAKTUAR]* për shkak të disa tipareve dalluese të *[REDAKTUAR]*, fytyra, forma e trupit dhe gjatësia. Dhe shtoi se *[REDAKTUAR]* nuk kishte ndryshuar shumë".

Pyetja ime tani është: A i keni thënë me të vërtetë këto? Ja keni thënë këto Prokurorisë kur folët, kur biseduat me ta?

Pë. Po, i kam thënë.

Py. Faleminderit. Kam disa pyetje lidhur me këtë. A mund të na thoni cilat ishin këto tipare dalluese, pra, çfarë nënkuptoni ju ose nënkuptuat me tipare dalluese kur dalluat këtë personin, cilat ishin këto tiparet dalluese të cilat ju përmendni?

Pë. Shumë thjesht është. Fytyra, fytyra e tina, ajo hunda e tina, ajo fytyra e tina *[REDAKTUAR]* shpesh herë. Sa herë shoh një ëndërr a çka ajo më *[REDAKTUAR]*. Dhe është personi

që ka qenë *[REDAKTUAR]*, unë jam kanë *[REDAKTUAR]*, u duhke me *[REDAKTUAR]* Edhe ajo. Në bazë të atyre jam shku me spjegu edhe është personi që edhe kur *[REDAKTUAR]*, kur e kam vetë - e kini dhe në deklaratë - që kur e kam vetë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*?" më ka thënë "*[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*". Ky është ai person që më ka thënë.

Py. E kuptoj. Thjesht po përpiqem të kuptoj çfarë ishte një - - çfarë kishte kaq të veçantë në fytyrë që ti e dallove. The hunda, ç'kishte hunda e tij kaq të veçantë që të ndihmojë ty ta dalloje personin?

Pë. Po më duket se *[REDAKTUAR]*, sende dhe është -- s'di qysh me ta shpjegu. Është problem. Është në kryet e tem. Është në blicin tem. Nuk ka shans këtë njeri me më ik. Çdo person që ta kam përmend aty mundet me ndodhë ndonjë mos e ngjoftë, por në përgjithësi i njoh *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Ama se aty ka pasë edhe persona të tjerë që sot që më përpara unë nuk i njoh, s'më intereson se s'më ka bë keq. Këta ça më kanë ba keq i ki në deklaratë i ki krejt. Është problem mu më ik ndonjë person *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Py. Kuptoj. Thatë *[REDAKTUAR]*. Po prapë pyetja ime është: Ndonjë gjë tjetër, ndonjë gjë tjetër e veçantë në fytyrën e tij që të ndihmoi që ta dalloje?

Pë. Jo, s'kam diçka të veçantë. Fytyra e tina ashtu. Nuk kam diçka të veçantë me ta cek bash saktë nuk kam.

Py. Vetëm fytyra pra. Në rregull. Po forma e trupit, lloji i trupit, çfarë kishte kaq të veçantë tek trupi i tij që menjëherë të ndihmoi që të dalloje personin?

Pë. Po ndoshta ka qenë *[REDAKTUAR]* se ta dhe ma ndoshta pak *[REDAKTUAR]* se të tjerët diçka.

Py. Nuk kishte askënd tjetër në Gjykatë kur dëshmoi ai edhe pyetja ime është: Ju po përcillnit dëshminë e tij dhe çfarë kishte kaq të veçantë në trupin e tij që ty të bëri të mendoje "Ah, ky është ai person?". A ka ndonjë gjë kaq të veçantë në trupin e tij që të shërbeu ty si tregues që ta dalloje?

Pë. Nga motin qysh -- ti s'po don a me më kuptu. Unë të thashë dhe e kam pa këtu në televizion edhe para tri vjetëve, ndoshta ka katër vite, që ka dalë në televizion ka dikund. Unë këtë e njoh edhe më herët, nuk është puna që e kam njoh veç këtu në seancë. Këtë e kam pa edhe ma herët. Po ndoshta ti po don ndonjë send tjetër. Ma specifikisht nuk po di çka me ta cek. Nuk është puna që e kam njof veç në seancë që e ke pru ti këtu. E kam pa edhe ma herët e kam njoftë e kam pa *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, hiqini pak dëgjueset, ju lutem. Duam të diskutojmë diçka me Avokatin Mbrojtës.

Avokat, e ka thënë se ishte *[REDAKTUAR]*, ishte *[REDAKTUAR]*, ishte më zhvilluar fizikisht. Dhe kështu si e kuptova unë, të paktën si e kuptova unë, këto janë ato tipare që e ndihmuan

atë ta dallonte këtë person konkret qysh atëherë.

Aso kohe, në 1999, ai kujtonte se ishte *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* fizikisht dhe si e kuptoj unë dëshmitarin, ai po thotë që "Unë pashë personin me të njëjtat tipare".

Kështu që ju lutem mos i thoni që nuk po e thotë, po e thotë ça tiparesh dalloi. Unë s'po e kuptoj pyetjen tuaj.

Z. VON BONE: [Përkthim] Thelbi, pra, në përgjigjen e tij ai përgjigjet për diçka në të shkuarën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo. Po lidhet dhe me të tashmen. Kjo është e qartë për mua. Po të thotë çfarë ka ky person të ngjashme me personin e asaj kohe.

Z. VON BONE: [Përkthim] Për të qenë i sinqertë, unë thjesht citova paragrafin. Dhe ai thotë dhe unë do të dal tek thelbi. Ai nuk mund t'i referohet 1999. Duhet t'i referohet atij momenti, asaj date konkrete që ka përmendur, pra, datën, ditën që e ka dalluar në bazë të këtyre tipareve të veçanta. Dhe tiparet dalluese s'i kam prekur fare. Ai tha fytyrën, tani përmendi dhe trupin. Dhe unë dua të di çfarë kishte te trupi i tij kaq të veçantë që tha "Ah, ky është personi".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, jua shpjegova dhe do ta përsërisë edhe njëherë si e kam kuptuar unë atë që ka thënë dëshmitari. Ju mund të vazhdoni me pyetjet tuaja, sigurisht, por unë do ju ndaloj nëse unë mendoj se po e ngatërroni dëshmitarin, se për mua ai ua dha përgjigjen, ua shpjegoi çfarë dalloi ai tek personi.

Ju mund të vazhdoni, por do ju ndaloj nëse e gjykoj të nevojshme.

Vendosini dëgjueset, ju lutem, z. Dëshmitar.

Vazhdoni, z. Avokat.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Z. Dëshmitar, ju i thatë ZPS-së, Prokurorisë, se e dalluat për shkak të gjatësisë. Pyetja ime është: Po ju e patë personin në këmbë në Gjykatë? E patë këmbë në sallën e gjyqit?

Pë. Jo, jo. Unë veç e di që ai është i gjatë. Unë nuk e kam pa këtu a u çu a u ul. Se dhe s'më ka interesu fort. Unë kam pasë atë mllefin tem. Po unë e di që ai është i gjatë.

Py. E kuptoj. Ju e dini që është i gjatë. Po. Por kur ishte ulur këtu nuk mund të thonit nëse ishte i gjatë apo jo. Kështu?

Pë. Unë për këtu nuk e kam pasë fjalën, as me Prokurorin, as kurrgjë. Më ka thënë -- i kam tregu se këtë e kam pa dhe më përpara, e njoh qysh prej 1999 dhe *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* aty pothuajse. Unë jam shku ça a mbetë në kry tem, pak a shumë me shpjegu qysh a ky njeri.

Py. E qartë. E kuptoj. E kuptoj këtë. Thjesht po përpiqem të përqendrohem çfarë pe kur po dëshmonte ai? Çfarë ishte ajo gjëja që pe kur po dëshmonte ai? Ky është thelbi im.

Dhe prandaj pyetja është: A mund të dallonit ju gjatë kohës që ai ishte ulur këtu nëse ai person ishte *[REDAKTUAR]* apo jo?

Pë. Jo, jo s'muj me ta vërtetu këtu. S'e kam pa. As më ka interesu. Beso që kur jam bë nervoz, as më ka interesu me këqyrë as çka po thotë, as çka mu -- automatikisht pothuajse dola pi kontrollit edhe ashtu. Edhe s'më ka interesu as me e këqyrë. Se me të thanë të drejtën edhe sytë më dhëmbin me e pa. Më vjen keq po.

Py. Z. Dëshmitar, shkruhet, thuhet -- ju keni shtuar që "*[REDAKTUAR]* nuk kishte ndryshuar shumë". Kështu?

Pë. Për mendimin tem, nuk ka ndryshim të madh. Ndoshta e ka *[REDAKTUAR]* ama s'ka ndryshim që me thanë diçka të madhe.

Py. Z. Dëshmitar, ju e patë teksa dëshmonte këtu në sallën e gjyqit, apo jo? E patë?

Pë. Po. E kam pa, po s'kam dëgju kështu me vëmendje ça po thotë ose diçka. Nuk e kam dëgju fort.

Py. E kuptoj. E dini çfarë kishte veshur?

Pë. Kështu një farë si setër, çka po di.

Py. E dini apo mendoni se kishte veshur këtë setrën? Çfarë patë?

Pë. Në bazë të asaj ça pashë, s'kam ndonjë lloj -- sikur që janë ka tesha, një setër vallë. Se s'më ka interesu ma specifikisht diçka kështu, se kur e kam pa ma s'më ka hup barabari krejt, a din. S'mujsha me i besu as vetvetes që është e mujshme që ai me u ul këtu.

Py. A ju kujtohet ngjyra e asaj që kishte veshur?

Pë. Nuk e di bash saktë çfarë ngjyre. Tash mund me kanë sikur kjo ngjyra a diçka *[REDAKTUAR]*. Se s'jam koncentru me këqyrë këtë send.

Py. Po flokët si i kishte e mban mend?

Pë. Flokët s'ia kam këqyrë vallaj.

Py. Ndonjë gjë të veçantë në fytyrën e tij që juve ju bëri të mendonit ose që juve ju ndihmoj të kuptonit, të dallonit që ky ishte burri, ai person?

Pë. Jo, s'kam kurrë farë, kurrë farë specifike është. Diçka nuk kam, po është personale se e njoh edhe ma herët po të them. Se s'më kanë interesu ato detaje, ato sende, se nuk isha interesu më as me e pa besa.

Py. Z. Dëshmitar, ju thoni se e njihnit që më përpara. A e keni parë dhe tek *[REDAKTUAR]* ju atë?

Pë. Është e mundshme.

Py. Unë po ju pyes: E keni parë apo nuk e keni parë?

Pë. Edhe unë po të tregoj që është e mujshme që e kam pa. Tashti nuk po më kujtohet bash tash për momentin, po mund të ndodhë që e kam pa.

Py. Në rregull. Që nga momenti që e keni pa *[REDAKTUAR]* dhe deri ditën që e *[REDAKTUAR]*, kur po *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* e kishe parë më herë tjetër nga ajo ditë e deri ditën që dha intervistën, ndërmjet kësaj periudhe domethënë?

Pë. Nuk e di tash me periudha, po ka ndodhë që e kam pa aty

*[REDAKTUAR]*, po e kam pa tani dhe kur *[REDAKTUAR]*. Tash saktë bash kur, qysh, nuk më kujtohen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat, ju lutem a mund të na jepni të lutem referencën për *[REDAKTUAR]*.

Z. VON BONE: [Përkthim] Referenca është SPO, Pjesa 2, faqja 25, rreshtat 15 -- më falni. Rreshtat 11 deri në 18; edhe rreshtat 20, 21; edhe faqja 26, rreshtat 13 deri 25; dhe faqja 27, rreshtat 2 deri në 9. Do të jap dhe ERN e cili është 060698-TR-ET, Pjesa 2, E rishikuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. VON BONE: [Përkthim] Kjo është referenca *[REDAKTUAR]*, të nderuar Gjykatës.

Py. Pra, në fakt, ju e keni parë atë personin, që thoni se keni dalluar edhe herë të tjera më përpara edhe e patë edhe këtu në sallë e gjyqit tek sa jepte dëshmi. Pra, në këto rastet e mëparshme që e keni parë, a u zemëruat po ashtu, a shqetësuat kur e keni parë herë të tjera?

Pë. Po, normal po.

Py. Dhe kur ishit në *[REDAKTUAR]*, a nuk kishit *[REDAKTUAR]* aso kohe që mund ta shihnit apo kur e shihnit ose që e shihnit ose ju shihnin?

Pë. Po, *[REDAKTUAR]*. Po unë tanë jetën *[REDAKTUAR]* qysh prej 1999. *[REDAKTUAR]* që këtu që jam përballë teje po,

domethënë, nuk kam mëndu atëherë q'aq. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, një farë sendi, s'të ka interesue se ty ashtu kështu. Qysh 1999 ti je *[REDAKTUAR]*.

Po veç kureshtja më ka shti me shku me i pa, me i këqyrë. Se *[REDAKTUAR]* normal, *[REDAKTUAR]* ke pasë të gjithë.

Py. Z. Dëshmitar, ju dëshmuat sot, në faqen 23 të transkriptit, rreshtat 4 deri në 9, ju thatë si në vijim:

"Po teksa kur po shihja atë seancën, automatikisht e njoha, e dallova. E kam në memorie. E kam në kujtesë. Nuk mund ta harroj atë person. Ai person nuk do iki kurrë nga kujtesa ime. Nuk do hiqet kurrë nga kujtesa ime".

Kështu thatë?

Pë. Po. Kështu thatë. Dhe s'ma merr mendja që mundet me të ik. *[REDAKTUAR]*, normal që nuk mundet me të ik. Edhe s'mundesh me harru. Edhe ty s'e kishe harru po të ishte në lëkurën tënde.

Py. Qartë. Ju ka lënë, ju ka ngelur, ju ka lënë gjurmë tek ju, apo jo?

Pë. Po jo gjurmë, po edhe pasoja shumë të mëdhaja që i barti unë sot.

Py. Z. Dëshmitar, a mund të na shpjegoni -- pra, ju thatë se *[REDAKTUAR]*. A ju kujtohet *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, pra, cilët persona keni përmendur që ju kanë marrë *[REDAKTUAR]* drejt *[REDAKTUAR]*?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Dëshmitar, hiqni pak dëgjueset, ju lutem. Duam të diskutojmë diçka me Prokurorin.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në fakt, pyetja ime ishte që duhet ta kufizojmë objektin e kundrapyetjes. Ne e diskutuam me dëshmitaren sot *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]*. Folëm për dallimin e disa personave, për dallimin e një personi që ndodhi gjatë një seance në mars. Ne nuk shkuam përtej në pyetjet tona dhe nuk mendoj se edhe Avokati Mbrojtës duhet të shkojë përtej këtij objekti, përtej këtij fushëveprimi.

Dhe dua gjithashtu të them, i njëjti dëshmitar ka qenë para këtij Trupi Gjykues para disa muajsh dhe Mbrojtja pati plot mundësi t'i bënte të gjitha pyetjet për të gjitha rrethanat e kësaj çështje dhe mund ta kishin pyetur për çdo aspekt të dëshmisë.

Unë tani nuk mendoj se këto pyetje lidhen me pjesën lëndore të pyetjeve shtesë që ne deshëm të bënim sot.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Prokuror.

Z. Avokat, keni fjalën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Në fakt, është vetë dëshmitari që i përmendi dëshmitë, deklaratat ku ka përmendur këta persona. Dhe kështu që unë dua t'i them se, në fakt, nuk është kështu. Po them gjëra -- këto janë gjëra që ka thënë vetë dëshmitari.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

kuptoj pikën tuaj, z. Prokuror. Por unë mendoj, e kuptoj dhe ku do të dali Avokati Mbrojtës, kështu që mund të jetë dhe një pyetje e Trupit Gjykues.

Kështu që, meqë jemi këtu të zbulojmë të vërtetën, mendoj se e rëndësishme të shkoj më tej në këtë aspekt. Por një koment i përgjithshëm nga ana ime është për ju, Avokati Mbrojtës, ju nuk na keni dhënë asnjë arsye pse po flisni konkretisht për këtë. Po përpiqemi të jemi sa më specifik. Megjithatë, unë e kuptoj qëllimin tuaj, kështu që mund të vazhdoni me pyetjen.

Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por në fillim, le t'i kërkojmë dëshmitarit të vendosi përsëri kufjet.

Z. Dëshmitar, mund të vendosni kufjet.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Z. Dëshmitar, më herët, pra, folëm që *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* A ju kujtohet kë keni përmendur në *[REDAKTUAR]*, pra, për cilët persona i keni përmendur ju atëherë, për personat që ju morën *[REDAKTUAR]*?

Pë. Po më kujtohen ka qenë *[REDAKTUAR]* edhe një *[REDAKTUAR]* ka qenë, nëse nuk gaboj. Këta persona.

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Nuk e di unë se ça kanë shkru aty.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, a mund të na thoni referencën?

Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, do ta jap tani. Bëhet fjalë *[REDAKTUAR]* pra.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Pra, sa e kuptoj, nëse e kuptoj unë siç duhet përgjigjen tuaj, ju po thoni ti s’e di, nuk e di ç’kanë shkruar ata, por ti, në fakt, i ke thënë këta emra, apo jo?

Pë. Po ma merr mendja që i kam thënë tash, qysh i kam thënë edhe këtu po ma merr mendja që edhe aty i kam thënë. Po ato kanë qenë kushte jashtëzakonisht -- *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. Faleminderit.

Z. VON BONE: [Përkthim] Referenca është 700687 dhe vazhdon deri në 691 dhe është faqja 1.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse doni të citoni diçka, do të preferoja që ta nxirrnim në ekran, ta shfaqnim në ekran pra.

Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po nuk e di nëse do të citonit diçka.

Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk do të citoj asgjë po thjesht dua të diskutoj diçka lidhur me këtë pjesë, me këtë fragment.

Py. Z. Dëshmitar, te deklarata që i keni dhënë UNMIK-ut, nuk keni përmendur asnjëherë *[REDAKTUAR]*. A mund të më shpjegoni pse? Si është e mundur?

Pë. Nuk e di qysh është e mujshme. Me përmend e kam përmend. Se edhe sot edhe 50 pas jetë, unë atë e përmendi dhe e kisha përmend. Pse? Aty është çështje atyre kush ka shkru. Nuk e di. S'e nuk është e mujshme kjo ça po thu ti, mos me përmend unë atë.

Py. E kuptoj.

Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë mund ta shfaqim në ekran, të nderuar Gjykatës. Është versioni me shkrim dore si dhe versioni anglisht. Versioni anglisht fillon me 700687. Ndërsa shqipja fillon me 689 dhe mbaron tek 691.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

lutem vendoseni, znj. Sekretare.

Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk jam i sigurt ku është në ekran. Më jepni pak kohë. Nëse shkojmë në faqen e fundit 691, të versionit shqip. Do të doja të shkonim në fund. Mbase po ta zmadhojmë pak që të shohim pjesën majtas në fund.

Py. Z. Dëshmitar, në të majtë, e shihni në të majtë, e shihni nënshkrimin? Poshtë majtas.

Pë. Po.

Py. Nënshkrimi juaj është ky?

Pë. Po.

Py. Shumë faleminderit.

Z. Dëshmitar, dua t'ju pyes përsëri. Si është e mundur që në atë deklaratë përmenden disa njerëz prej jush, por ju nuk e keni përmendur asnjëherë *[REDAKTUAR]* ose emrin e vërtetë të *[REDAKTUAR]*? Si është e mundur kjo?

Pë. Nuk e di qysh është e mundur. Mundet me ndodhë. Çka s'mund të ndodhë. Mundet me ik ai çast ose diçka po s'po ma merr mendja që se kam përmend atë njeri se s'ka shans me përmend personin e parë, tani të dytin. Jo, nuk ka shans edhe njëri që të ka marrë edhe ka zhvillu lloj-lloj torture me ty edhe *[REDAKTUAR]*. Edhe është personi që s'mund e harroj këtë se kur e kam vetë "*[REDAKTUAR]* Më ka thënë *[REDAKTUAR]* A po kupton? Mundet njeri me harru tjetër kënd, ama këtë jo.

Çka ka bë këtu, çka u bë nuk e di. I keni përpara

analizoni, këqyrni. Është krejt okej.

Py. Shumë faleminderit, z. Dëshmitar. Tani duke folur
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Përpara sesa të vazhdojmë më tej, z. Dëshmitar, ju lutem a mund t'i hiqni dëgjueset.

Avokatja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Njësoj si me ndërhyrjen e fundit timen, jam kundër pyetjes së bërë, sepse kjo është diçka për të cilën dëshmitari nuk mund të japë dëshmi. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Çfarë pyetje do të kishit ju, Avokat i Mbrojtjes?

Z. VON BONE: [Përkthim] Është fakt, të nderuar Gjykatës, që *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E di. E kam parë këtë. *[REDAKTUAR]*. Nuk është diçka që --

Z. VON BONE: [Përkthim] Po këtë thënë dëshmitari. Sepse *[REDAKTUAR]*. Ky është argumenti im.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po çfarë pyetje do bëni? Sepse kjo referencë -- e shoh që jeni ngritur z. Prokuror. Do jua jap fjalën.

Po ndoshta është më mirë që t'ia jap fjalën së pari Prokurorit dhe pastaj të vazhdojmë me argumentin tim.

Z. Prokuror, e keni fjalën ju.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në mënyrë të ngjashme me atë çfarë thashë më përpara, pyetje të cilat kanë të bëjnë me afatet, të cilat kolegu im i nderuar po mundohet që t'ia bëjë së shkojnë përtej fushës së veprimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit sot.

Siç e thashë edhe më përpara, ka pasur kohë të mjaftueshme dhe hapësirë të mjaftueshme për t'ia bërë këtë pyetje dëshmitarit kur ka dhënë dëshmi herën e parë.

Dhe sërish do të doja të thoja që këto pyetje shkojnë përtej fushës së veprimit të pyetjeve që kemi bërë sot.

Në qoftë se pyetjet e ditës së sotme kanë të bëjnë me identifikimin, e kuptoj që pyetjet e tjera duhet të lejohen. Megjithatë pyetjet të cilat kanë të bëjnë me kohën kur pretendohet që personat janë mbajtur në qendrën e ndalimit ose kanë pësuar maltratime këto shkojnë përtej objektit të shqyrtimit të ditës së sotme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, a keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar përveç asaj që diskutuam?

Z. VON BONE: [Përkthim] Kjo ka të bëjë me atë çfarë mban mend ky person, lidhur me një incident një person, deklarata, dëshmi që ka dhënë ai dhe kjo është çështja apo aspekti që ne po mundohemi të përcaktojmë këtu. Pra, nuk kemi të bëjmë vetëm thjeshtë me dallimin por kemi të bëjmë edhe me faktin që çfarë të kujtohet në atë kohë. Unë mendoj, besoj, të nderuar Gjykatës, që ne po mundohemi të përcaktojmë të vërtetën, të vërtetojmë të vërtetën, kjo është në interes të drejtësisë, pra, çfarë reagimi ka dëshmitari lidhur me këtë aspekt. Sepse është e qartë ajo çfarë ka dëshmuar ky dëshmitar dhe në qoftë se dëshmitari e mban mend atë çfarë ka thënë. Për shembull, në deklaratën që sapo e diskutuam ai tha që “E mbaj mend që e kam thënë këtë gjë”, por, ai, sigurisht, nuk e ka prekur atë çfarë është shkruar këtu. Kjo është fusha e veprimit të pyetjes time.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ju

jap fjalën, z. Avokat i Mbrojtjes.

Por kam një pyetje për ju pse nuk ja keni bërë këtë pyetje më përpara dëshmitarit?

Z. VON BONE: [Përkthim] Pse nuk ja kemi bërë këtë pyetje më përpara?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, në një rast tjetër më para.

Z. VON BONE: [Përkthim] Në një rast më hershëm. Së pari kemi diçka që mbahet mend që ka të bëjë me këtë diskutim sot. Pra, lidhur me atë se çfarë thotë ky person që mban mend kë pa, ku e pa, kur. Pra, ne nuk mund të bëjmë ndarjen dhe të themi jo, jo që kjo është kjo është diçka që mbaj mend unë lidhur me këtë person. Por kjo duhet të shikohet në një kuadër më të gjerë. Pra, duhet të shikohet me një ngjarje specifike. Pra, në përgjithësi, kjo është mënyra sesi funksionon kur bëhen pyetje që kanë të bëjnë me kujtimin e diçkaje. Për shembull, ti thua që më kujtohet ky person në këtë vend që ka bërë këtë gjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të kërkoj ndjesë, Avokat i Mbrojtjes, mbase nuk isha e qartë.

Por pyetja që ka të bëjë me aktgjykimin, që ju mendoni që mund të jetë në kundërshtim me deklaratat e mëparshme që ka dhënë ky dëshmitar, ne e kemi pasur këtu në Gjykatë më përpara. Ky nuk është informacion i ri me ç’kuptoj unë. Dhe kjo çështje nuk është diskutuar me dëshmitarin. Kështu që

pyetja që kam për juve është pse nuk e keni diskutuar në atë kohë me dëshmitarin.

Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk është diskutuar sepse unë kam gjysmën e kohës në dispozicion nga palët e tjera, për çfarëdolloj teme dhe kjo është një çështje sesi dikujt i kujtohet diçka. Kjo është e gjitha këtu.

Unë besoj, që është vërtet në interes të drejtësisë që të zbulojmë të vërtetën lidhur me atë çfarë thotë dëshmitari. Sigurisht në qoftë se jemi këtu për të vërtetuar të vërtetën. ZPS-së nuk i pëlqejnë përgjigjet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, më dëgjoni.

Thjesht dua që t'ju siguroj që këtu jemi për të vërtetuar të vërtetën, për të zbuluar të vërtetën. Kaq e them me siguri. Këtu jam dakord me ju.

Avokatja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Thjesht për të shtuar. Shkurtimisht. Sipas pikëpamjes time, jemi në një linjë pyetjesh që janë përsëritëse dhe janë pyetje të cilat nuk janë bërë sot, por po i referohet z. Avokat i Mbrojtjes transkriptit të seancës të mbajtur *[REDAKTUAR]*. Për shembull, sot, në faqen 958, Mbrojtja jo vetëm që ka pasur mundësinë po ka përdorur gjithashtu mundësinë që *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Për pasojë, dua të them që, ky nuk është rasti i vetëm që Avokati i Mbrojtjes ka pasur mundësi që të shtjellojë më tej dhe që të nxjerrë në pah të vërtetën. Domethënë janë thjesht çështje që përsëriten sipas këndvështrimit tim.

Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mundem --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po mundeni, por dua që vlerësoj dhe të ndjek çdo koment që ka të bëjë me themelin e çështjes.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
mundësi të identifikoja duke pasur parasysh kohën e kufizuar në dispozicion për të demonstruar që, në fakt, Mbrojtja ka pasur mundësi që ta shtjellonte këtë çështje dhe në fakt, e shënjuar më parë.

Por mbase mund të shtoj dhe diçka tjetër. Dhe disa faqe më përpara asaj çfarë citova, Mbrojtja ka bërë të njëjtat

pyetje që dëgjuam dhe sot, për shembull, në qoftë se nënshkrimi është i njëjti apo jo. Në atë seancë dhe ne kemi eksploruar gjerë e gjatë me dëshmitarin në qoftë se përkthimi dhe interpretimi i deklaratave *[REDAKTUAR]* kanë *[REDAKTUAR]* Dhe dëshmitari ka thënë që nuk ka qenë i kënaqur me një pjesë të këtyre produkteve por edhe nuk ka qenë në gjendje të mirë. Këto janë çështje të cilat i kemi diskutuar dhe shtjelluar në gjerësi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të them se, z. Prokuror, ngushtimi i marrjes në pyetje nga Mbrojtja, nga Avokati i Mbrojtjes, për arsyen e thirrjes së dëshmitarëve sot në seancë, unë do të jap sa më shumë hapësirë sepse mendoj që t'i japim mundësi të gjithë palëve që të shprehen dhe që të dëgjohen në këtë sallë gjyqi në mënyrë që të kemi mundësi të zbulojnë të vërteten.

Por, Avokati Mbrojtjes, kam përshtypjen sikur
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* me dëshmitarin. Megjithatë unë jam

këtu, me ju dhe dua ta theksoj këtë, sepse dëgjova diçka në komentet tuaja dhe në zërin tuaj që, ndoshta e dëgjova gabim. Por thjesht dua që ta theksoj këtë gjë që këtu jemi për të zbuluar të vërtetën. Dua t'iu jap fjalën dhe jua kam dhënë fjalën në fakt për diçka që është më e madhe sesa çështjet e shqyrtuara sot. Megjithatë kjo mund ishte një pyetje që mund ta kishte bëre dhe Trupi Gjykues. Sepse për mua nuk dallim në qoftë se pyetje mund të bëhej, për shembull, nga Trupi Gjykues ose jo. Ndërkohë *[REDAKTUAR]*, më duket sikur është problematike që të bëhen pyetje lidhur me të.

E kemi kaluar tashmë një orë dhe dua t'ju them që dua t'ju jap kohën e nevojshme për të mbrojtur klientin tuaj. Të jeni të sigurt për këtë gjë. Dhe besoj se e keni parë që Trupi Gjykues ka bërë këtë gjë në vijimësi.

Shikoj që e tundni kokën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Po, po nuk ka pikë dyshimi lidhur me këtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duam që të jemi të qartë lidhur me këtë pikë.

Z. VON BONE: [Përkthim] A mund të shtoj diçka që kam në mendje?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë doni të pyesni?

Z. VON BONE: [Përkthim] Është lidhja që bëri dëshmitari kur *[REDAKTUAR]* dhe pyetja ka të bëjë me atë çfarë ka thënë

z. *[REDAKTUAR]* me kohën kur *[REDAKTUAR]* ai dhe ai e lidhi këtë në një moment të caktuar që pas *[REDAKTUAR]*. Megjithatë nuk është e vetmja gjë kjo që tha lidhur me lirimin e tij. Dhe prandaj, unë mendoj, *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kuptoj, por tani nuk ju lejoj që të vazhdoni më tej me këtë çështje. Dhe do të bëjmë një pushim pas 15 minutash. Pasi ta lexoj këtë pasazh edhe një herë tjetër. Në qoftë se mendoj që është me vend që t'ju jap fjalën të mund të vazhdoni me këtë pyetje, do ta bëj këtë gjë.

Pyetja tjetër është kjo: Edhe sa kohë mendoni se ju duhet?

Z. VON BONE: [Përkthim] Ndoshta 15 minuta, jo më shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E keni ju fjalën përsëri Avokat i Mbrojtjes.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Më falni, z. Dëshmitar, na duhej që të sqaronim diçka.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, dëshiroj t'i them diçka dëshmitarit.

Z. Dëshmitar, ju kërkojmë ndjesë, se ndonjëherë ju kërkoj që të hiqni dëgjueset edhe pastaj pas ca kohe të vendosni përsëri dëgjueset, por na duhet ndonjëherë që të diskutojmë pyetjet që ju drejtohen juve dhe duam që të mos dëgjoni, në mënyrë të tillë që të mos të ndikojmë në përgjigjen që do të na jepni ne. Kështu që na duroni dhe pak. Edhe ju falënderoj edhe njëherë për durimin

DËSHMITARI: Okej. S'ka problem. Në rregull është.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E keni fjalën, z. Avokat i Mbrojtjes.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Z. Dëshmitar, do t'i kthehem dhe njëherë asaj çfarë unë e quaj Nota Zyrtare e Prokurorisë. Unë e lexova edhe më parë paragrafin 4 dhe do lexoj dhe njëherë për juve. Do them çfarë është shkruar në këtë paragraf.

Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, bëhet fjalë për paragrafin 4. Është dokument i identifikuar me numrin ERN 105371.

Py. "Dëshmitari W01679 u konfirmoi z. Prokuror dhe znj. Prokurore se personi të cilin e kishte parë duke dëshmuar më *[REDAKTUAR]*, ishte në të vërtetë *[REDAKTUAR]* që e *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* në Brigadën 153".

Deri tek kjo pjesë, z. Dëshmitar.

Në fakt, në qoftë se do lexoja deklaratat tuaj do më rezultonte që *[REDAKTUAR]* nuk *[REDAKTUAR]* asnjëherë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund të bëni pyetje me fund të hapur, të lutem? A të ka arrestuar apo jo *[REDAKTUAR]*?

Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jo, unë besoj se është e drejtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo. Thashë jo. Dhe të lutem, bëni një pyetje me fund të hapur.

Z. VON BONE: [Përkthim]

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Nuk e di. S’po ma merr mendja që s’e kam përmend, po nuk e di qysh nuk është e shkrune dikund. Po çuditna dhe unë.

Py. A mund të ketë ndodhur që ta kesh harruar ta përmendësh atë në atë kohë?

Pë. Nuk ma merr mendja që e kisha harru bash *[REDAKTUAR]*. S’ma merr mendja.

Py. Apo mund të ketë ndodhur që të keni biseduar me dikë që ju ka thënë juve që të thoni që *[REDAKTUAR]* ka qenë aty?

Pë. Jo, jo s’kam bisedu unë me kërrkënd. As nuk bisedoj unë kësi gjena me kërrkënd. Po është njëri që, thashë edhe ma

herët, ju thashë, është *[REDAKTUAR]* tem edhe nuk heket ai njeri.

Edhe tjetra send që se s'un e harroj këtë njeri është se - po të them apet për herë të tretë – kur *[REDAKTUAR]* më ka thënë *[REDAKTUAR]*

Py. Z. Dëshmitar, keni thënë në deklaratën që i keni dhënë Prokurorisë dhe i referohem këtu transkriptit me numrin e identifikimit ERN 0606 -- 00257 deri në 00266-ET, më datë 5 qershor, pjesa e dytë e këtij dokumenti, në faqen 23, rreshti 7 deri në 19. Keni thënë:

"Të gjithë e njohin *[REDAKTUAR]*".

Si ka mundësi që ky person të jetë kaq i njohur?

Pë. Po është i njohur. Ku ta di unë se si. Si *[REDAKTUAR]* që është kanë. Ku ta di unë pse është i njohur. Nuk di unë pse është i njohur. Pi sendeve të mira që i ka bë ndoshta.

Py. Ju thoni që ka qenë *[REDAKTUAR]*. Jeni i sigurt për këtë?

Pë. Po edhe unë sipas fjalëve të njerëzve edhe sipas këtyne gjërave e di që ka qenë zëvendësi i tij.

Py. Po nuk e dini vetë. Ça doni me thënë "sipas fjalëve të njerëzve"? Nga kush e keni dëgju këtë gjë?

Pë. Nuk më kujtohet tash pi kujna e kam ndigju po është flit për të, bajagi një kohë të gjatë është flitë për të si heroj, si komandanta e ku ta di unë. Deri sa e morën vesh edhe njerëzit kush janë, çka janë, ça kanë bo.

Py. Z. Dëshmitar, a keni përmendur ndonjëherë ndonjë person

tjetër si zëvendësin e z. Mustafa?
Pë. Po, kam përmend. Sa më kujtohet, po.
Py. Dhe kush jua ka thanë këtë gjë?
Pë. Kam dëgju pi njerëzve, pi.
Py. A e dini në qoftë se këta njerëz kanë punuar me *[REDAKTUAR]* apo kanë punuar me z. Mustafa?
Pë. Nuk e di a kanë punu, po ça unë di ato kohë kanë qenë të vështira. Nuk ke mujtë me hi ti bash në detaje çka ka bë, qysh, tek, çka u kanë ky. Vjen po sipas fjalëve, sipas sendeve jo komandant, jo zëvendës, jo --
Py. Pra, nuk e dini nga vetja, por e dini nga ato çfarë keni dëgjuar nga njerëzit e tjerë, çfarë ju kanë thënë të tjerët. E kuptoj drejtë kështu është?
Pë. Për *[REDAKTUAR]*, po ashtu është.
Py. E kuptoj. Kur *[REDAKTUAR]* ka dhënë dëshminë dhe ju e dalluat atë si *[REDAKTUAR]*, pra, kur *[REDAKTUAR]* ishte këtu përpara Gjykatës për të dhënë dëshmi, a e kujtoni shumë mirë atë moment, domethënë, momentin kur e dalluat që ishte ai?
Pë. Po e kujtoj sikur ty që po të shoh që tashti si të shoh të njoh. Dhe normal që e njoh po.
Py. A të kujtohet se për çfarë teme po fliste ai kur e patë në atë moment dhe kur ju e njohët që ishte ai?
Pë. Jo, nuk më kujtohet çfarë teme ka qenë. Se që e pashë ashtu, u hutova me thanë të drejtën, u hutova edhe di qysh më hupi krejt mua ajo se s'më ka interesu çka thotë ai. Mu më ka

interesu qetu me shpjegu, me pru këtë mesazh tek Gjykatësja dhe tek Prokurori edhe tek Avokatët e krejt me kallëzu se kush a ky njeri. Nuk e ka vendin për këtu. Nuk bën as me i ofendu as viktimën. A po kupton?

Qatë orientim e ka pasë. Nuk ka pasë -- s'kam kurrfarë orientimi ça ka thanë, çka po thotë se s'më ka interesu dhe s'më intereson. Po të them edhe ma herët thashë, sytë më dhembën me pa. Besomë. Më vjen keq po --

Py. E kuptoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat i Mbrojtjes, besoj se këto dy pyetje janë të përsëritura, shpresoj që pyetjet e tjera të mos jenë të kësaj natyre.

Z. VON BONE: [Përkthim] Janë pyetje përmbyllëse.

Py. A të kujtohet ndonjë temë konkrete që ka diskutuar ai, që në një farë mënyre ju ka tërhequr vëmendjen ose që ju bëri të nevrikosur, që ju bëri të ndjenit një lloj emocioni të caktuar, kishte ndonjë temë konkrete që ju kujtohet që ai po fliste që ju acaroi juve?

Pë. Jo, jo s'muj me të dhanë asnjë përgjigje. Nuk muj me të dhënë. Unë, personal, si e kam pa si është si dëshmitar, aty a kanë kapaki krejt. Çka thotë e çka don me thanë, s'më ka interesu absolut. Si e kam pa, *[REDAKTUAR]* këtu.

Py. Pra, nuk dini për ndonjë temë që ka diskutuar ai? Në

përmbledhje mund ta them.

Pë. S'më ka interesu. Se unë kam mujtë me lëshu edhe mbasandej me e hudh, po s'më ka interesuar, as më intereson.

Z. VON BONE: [Përkthim] Është e qartë. Shumë faleminderit për kohën, z. Dëshmitar

DËSHMITARI: Faleminderit dhe ju.

Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe mbaroj me pyetjet e mia këtu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Avokat i Mbrojtjes.

Z. Dëshmitar, do bëjmë pushim për 15 minuta, deri në orën 3.00. Pastaj do të vazhdojmë me pyetjet e Trupit Gjykues.

Znj. Sekretare, do t'ju shoqërojë për të dalë nga salla për të bërë pushimin.

DËSHMITARI: Okei.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem a mund të na sillni sërish në seancë publike, ju lutem.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Kemi përfunduar me marrjen në pyetje të dëshmitarit nga Avokati i Mbrojtjes. Tani do të bëjmë një pushim për 15 minuta

deri në orën 3.00 dhe pastaj do të vazhdojmë me pjesën tjetër.

--- Pauza fillon në orën 14.46

--- Seanca rifillon në orën 15.01

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Mirë se u rikthyet.

Z. Prokuror, përpara se të sjell Dëshmitarin dëshiroj të di prej jush ku jemi me pyetjet vijuese, ku qëndrojmë me pyetjet vijues.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi më pyetje të tjera.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Para se t'i drejtohem Avokates së Viktimave, për procesverbal konstatoj se jemi në të njëjtën përbërje si më herët.

Mbrojtësja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi më asnjë pyetje. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat. Ju ishit në fakt i fundit, kështu që nuk ka më pyetje në fakt, hamendësoj.

Në rast se nuk ka pyetje nga ZPS-ja dhe nga Mbrojtësja e Viktimave.

Po shoh kolegët.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.

Atëherë, do të thërrasim Dëshmitar dhe të mbyllim me këtë

Dëshmitar. Por, përpara se të bëjmë këtë, do të kërkoja të kalonim në seancë private por doja të thoja që kam edhe një urdhër me gojë që dua të jap në fund pasi mbarojmë me seancën private dhe të kalojmë përsëri në seancë publike.

Shumë mirë. Znj. Asistente, sillni Dëshmitarin dhe ndërkohë znj. Sekretare e Gjykatës të na kaloni në seancë private. Faleminderit

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. dëshmitar, mirë se na u rikthyet. Unë ndërkohë pyeta palët dhe Avokaten e Viktimave dhe më informuan se nuk kanë më pyetje për ju. E njëjta gjë vlen edhe për Trupin Gjykues. Nuk kemi më pyetje ç'ka do të thotë se erdhëm në fund të dëshmisë suaj. E kuptoj që ka qenë e lodhshme, angazhuese. Kështu që faleminderit për përpjekjet tuaja për dëshminë tuaj sepse unë besoj sikurse u kamë thënë edhe më herët se kjo do të na ndihmojë në përpjekjet tona për të zbuluar të vërtetën.

Faleminderit shumë. Ju uroj një rrugë të mbarë dhe nuk është nevoja të thuhet më, por nuk duhet ta diskutoni dëshminë që keni dhënë para Dhomave të Specializuara të Kosovës me askënd.

Ju faleminderit dhe znj. Asistente, tashmë do ju nxjerrë nga salla e gjyqit.

DËSHMITARI: Faleminderit shumë

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë publike përsëri.

[Seancë e hapur]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Përpara se të jap një urdhër me gojë dhe para se t'ju jap fjalën për ndonjë çështje që doni të parashtroni me Trupin Gjykues në këtë moment, për procesverbal dhe pa hyrë në diskutime tani lidhur me këtë temë, z. Avokat më duhet të them se kemi marrë Vendimin për Zhvillimin e Procedurave që është parashtrim i protokolluar 170 paragrafi 18 ku folëm për 50 për qind të kohës që ju është alokuar, akorduar ju në çështjen e ZPS-së. Dua të them që përveç se kohës efektive që u është dhënë konkretisht në procedura, ne kemi pasur edhe një urdhër me gojë të datës 13 dhjetor ku thuhet se ju është dhënë e njëjta kohë. Thjesht për procesverbal. Sepse ju thatë që ju është dhënë shumë kohë për të paraqitur provat tuaja, megjithatë mendoj se ishte me vlerë pa përmendnim këtë.

Do të jap një urdhër me gojë lidhur me transkriptin e sotshëm sepse për shumicën ka qenë në seancë private.

Në përputhje urdhrin e mëparshëm të Trupit Gjykues lidhur me heqjen e redaktimeve të transkripteve ose riklasifikimin që

është parashtrim i protokolluar 348 datë 18 mars 2022, Trupi Gjykues vlerëson të urdhërojë palët, Zyrën Administrative dhe Avokaten e Viktimave të rishikojnë transkriptin e seancës së sotme, data 1 qershor 2022 dhe të dorëzojnë parashtrim në formë të konsoliduar, të përmbledhur – më fal – nëse ka pjesë të transkriptit që mund të riklasifikohen si pjesë publike.

Palët, Zyra Administrative dhe Mbrojtësja e Viktimave do të ndjekin procedurat e përcaktuara në paragrafin 3 të urdhrit 348 të cilin e përmenda, të dorëzojnë parashtrimet e tyre brenda të premtes 22 korrik 2022.

Ata mund t'i integrojnë parashtrimet e tyre në pajtim me këtë urdhër në parashtrim që në fakt janë për t'u dorëzuar për të njëjtën, në të njëjtën datë në përputhje me paragrafin 4 dhe 5 të urdhrit 348, nëse dëshirojnë. Sepse në atë urdhër është bërë me dije se deri në cilën datë dëshiron të marrë parashtrimet përmbledhëse Trupi Gjykues. Dhe e fundit, parashihet për datën 22, data e fundit është 22 korrik 2022, kështu që mund të përfshijmë në transkriptin e ditës së sotme në këtë pjesë.

Me kaq mbyllet dhe urdhri me gojë i Trupit Gjykues.

Në rregull.

Z. Prokuror a ka ndonjë gjë që doni të parashtroni?

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. Sot në mëngjes po diskutonit me ne çështjen – diçka që mungon në përkthimin e librit. Përkthimi është gati dhe do të zbulohet ose sot ose

nesër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për atë faqen konkrete.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, pikërisht ajo faqja që përmendët, por do ta nxjerrim sot ose nesër të korrigjuar.

Mbrojtësja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

Sa i takon mënyrës si do të vazhdojmë me, si do të vijojmë me ekspertët. Ata po presin që t'ju komentoj unë, t'ju them unë nëse do të dëgjohen ose jo në datën 9 qershor, kështu që do e vlerësoja nëse mund të më thoni se si do të veprojmë në mënyrë që t'ua përcjell këtë informacion.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. Sapo të jetë e mundshme edhe kjo do të ndodhë shumë shpejt në fakt. Do të informoheni lidhur me aspekt. Po flasim për raportin e IMO-s, për ta thënë më shprehimisht. Faleminderit për këtë.

Fjala është për ju Avokati Mbrojtës.

Z. VON BONE: [Përkthim] Gjithashtu nëse do të ketë ndonjë seancë ose konferencë për ecurinë e çështjes në datën 8 ose 9 qershor, z. Mustafa kërkon ndjesë nuk mund të jetë i pranishëm sepse po i vjen familja. I vjen familja dhe është e vetmja mundësi për të për t'u takuar me familjen. Kështu që nuk jam i sigurt se cila është situata, kur, si është gjendja. Çfarë

seance parashihet apo programohet. Prandaj po ua them që të keni parasysh se ai mund të mos jetë i pranishëm.

Është e vështirë për familjen që të vijë kurdoherë, kështu që prandaj është e rëndësishme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po vijnë në datën 8 edhe 9?

Z. VON BONE: [Përkthim] Vijnë nga data 6 do të rrinë deri të dielën, s’e di çfarë dite i bie. 6-ta e mërkurë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] 7-ta është e martë. 8-ta e mërkurë, 9-ta e enjte.

6-ta i bie e hënë, pra është edhe pushim zyrtar.

Z. VON BONE: [Përkthim] Më duket se vijnë të mërkurën – më falni – të dielën, me fluturimin e të dielës deri të enjten. Sidoqoftë, doja ta vija në dukje. Doja ta vija në vëmendjen tuaj paraprakisht. Kështu që çfarëdolloj seance që të keni planifikuar mund të mos jetë i pranishëm.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Afati për palët për parashtrim, domethënë afati i parashtrimit të raportit është sot në fakt. Kështu që do ju njoftojmë sa më shpejt të jetë e mundur, nëse do të ketë seancë ose jo më datën 9.

Po do të dali me vendim tjetër ky informacion sot, lidhur me procedurat e zhdëmtimit. Për të qartësuar hapat e mëtejshëm lidhur me këtë.

Z. VON BONE: [Përkthim] Nëse mund të shtoj edhe diçka

tjetër.

Mbrojtja mund t'i kërkojë leje Trupit Gjykues për mbase disa materiale provuese të cilat dëshirojmë t'i dorëzojmë lidhur me ato sa kanë ndodhur në seancën fundit – lidhur me seancën më të fundit pra, disa nga shënimet ose komentet nga Prokuroria.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E keni fjalën lidhur me seancën e ditës së sotme edhe provat dokumentuese që propozohen nga ZPS-ja?

Z. VON BONE: [Përkthim] Po, po. Sidomos lidhur me seancën e sotme edhe periudhën paraprake. Ne po përpiqemi të fokusohemi tek kjo gjë në mënyrë që të gjejmë disa prova shtesë lidhur me këtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Provat dokumentuese?

Z. VON BONE: [Përkthim] Jo domosdoshmërish provat dokumentuese. Por po përpiqemi të fokusohemi te gjithë objekti i njohjes së tij ose fushëveprimit të njohjes. Mbase do përgatisim ndonjë raport apo diçka të ngjashme. Por është një nga gjërat që jemi duke u përpjekur të bëjmë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po shihni të gjithë fushëveprimin e njohjes? Dhe kjo mund të rezultojë në ndonjë raport?

Z. VON BONE: [Përkthim] Po në një raport që mund të duam ta dorëzojmë, kështu që mund t'ju kërkojmë leje Trupit Gjykues

që të dorëzojmë një parashtrim të protokolluar apo çfarëdolloj dokumenti që mund të përgatisim në vijim të kësaj. Pra situata siç doli ishte e -- nuk patëm mundësi ta përgatisim se ishte koha ishte shumë e shkurtër. Prandaj po shohim çfarë mund të përgatisim edhe do të përgatisim diçka lidhur me këtë aspekt.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sigurisht që do ju informojmë nëse, pra të dyja palët dhe Mbrojtësja e Viktimave do ju informojmë nëse Trupi Gjykues sipas rregullës 123 do të përgatisë provat që duan të sjellin. Pra do ju japim sigurisht mundësinë të përgatisni apo të sillni propozimin tuaj për prova. Është e parashikuar në Rregulloren e Procedurës dhe Provave.

Faleminderit që na njoftuat lidhur me këtë.

Në rregull. Nuk mund të them nëse do të takohemi javën tjetër më 9 qershor por do ju informojmë sapo të jetë e mundshme.

Faleminderit.

Seanca mbyllet deri në njoftim të mëtejshëm edhe do të ndajmë sapo të jetë e mundur kalendarin për javët e ardhshme në mënyrë që të kemi disa data me përafërsi për çështje organizimi.

Seanca mbyllet.

--- Seanca mbyllet në orën 15.17